Valle d'Aosta	Aosta	Quart*
Valle d'Aosta	Aosta	Valpelline*
Valle d'Aosta	Aosta	Valtournenche*
Valle d'Aosta	Aosta	Verrayes*
Valle d'Aosta	Aosta	Verrès*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërtetohet që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) Janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipeve të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërtetohet që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të



Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antittrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të *Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore*;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të *Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore*, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 të *Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore*, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të *Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore*.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikës 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 1191, datë 13.11.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

UDHËZIM
Nr. 7, datë 20.11.2025

**PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE NË MEDIAN E SHKRUAR,
ELEKTRONIKE DHE/OSE
AUDIOVIZIVE, SI DHE PËRJASHTIMET
PËR QËLLIMET E POSAÇME TË
PËRPUNIMIT**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 43, nenit 85, dhe pikës 2, të nenit 97, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim quajtur “Ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,



UDHËZON:

KREU I PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE NË MEDIA

Neni 1 Objekti

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për median e shkruar, elektronike dhe/ose audiovizive, publike ose private (në vijim “Media”), me qëllim për të garantuar përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, si dhe përcaktimin e rasteve kur aplikohen përjashtimet nga dispozitat e ligjit në përpunimin e të dhënave nga kontrollues që realizojnë veprimtari në fushën e gazetarisë.

Neni 2 Përkufizime

Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me ato të nenit 5, të ligjit. Shtohen në këtë udhëzim edhe përkufizimet e mëposhtme:

a) “Publikimi” është vënia në dispozicion e materialit tek një person tjetër, për botim nga ky i fundit;

b) “Gazetar” është çdo person që mbledh, përpunon, prodhon ose shpërndan informacion përmes mjeteve të komunikimit publik, me qëllim informimin e publikut, në përputhje me parimet etike dhe profesionale të gazetarisë;

c) “Redaktor” është çdo person që ushtron kontroll mbi përzgjedhjen/përpunimin e përmbajtjes së materialeve të destinuara për botim nga media elektronike, e shkruar, vizive dhe/ose audiovizive;

ç) “Arkiv i gazetareve” është tërësia e materialeve të mbledhura, përpunuara dhe ruajtura nga një gazetar/media në funksion të veprimtarisë së gazetarisë/medias për qëllime dokumentimi;

d) “De-indeksim” është procesi përmes të cilit një informacion hiqet nga lista e rezultateve të kërkimit, një lidhje (*link*) që përmban të dhëna personale, në mënyrë që ajo të mos shfaqet më kur kërkohen informacione për një person të caktuar nëpërmjet emrit të tij.

Neni 3 Dispozita të përgjithshme

1. Gazetari, redaktori dhe botuesi i medias duhet të zbatojnë të gjitha dispozitat e ligjit dhe këtij udhëzimi.

2. Media duhet të kujdeset që të mos publikojë informacione të paqarta, të pavërteta, përfshirë edhe imazhe që cenojnë të drejtat e subjekteve të të dhënave. Në momentin kur konstatohet një gabim, pasaktësi apo deklaratë e pavërtetë, duhet të procedohet me korrigjimin e menjëhershëm¹. Në media, duhet të bëhet i qartë dallimi midis fakteve reale, komentit, opinionit dhe hamendësimit².

3. Të dhëna personale sensitive që zbulojnë origjinën racore/etnike, mendimet politike, besimin fetar ose pikëpamjet filozofike, anëtarësimin në sindikata, të dhënat gjenetike, të dhënat biometrike, të dhënat për shëndetin, jetën ose orientimin seksual të një personi, mund të përpunohen në rast se zbatohen masa të përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave themelore e të interesave të subjekteve të të dhënave e me qëllim informimin mbi çështje me interes publik, vetëm nëse zbatohet parashikimi i germës “e”, të pikës 2, të nenit 9, të ligjit³. Në mënyrë alternative, bazuar në përjashtime të tjera specifike të parashikuara në të njëjtin nen dhe duke zbatuar në çdo rast rregullat e nenit 43 të ligjit, media duhet të respektojë, gjithmonë, thelbin dhe aktualitetin e informacionit, duke shmangur referimet ndaj të afërmeve apo individëve të tjerë apo të dhëna që nuk kanë lidhje me informacionin.

4. Të dhënat sensitive⁴ mund të përpunohen nga media vetëm me pëlqimin e subjektit të të dhënave

¹ Neni 15 i ligjit parashikon si një nga të drejtat e subjektit të të dhënave edhe të drejtën për korrigjim dhe fshirje. Shih gjithashtu, pikën 1, faqja 5 të Kodit të Etikës së Gazetarit, të hartuar me mbështetjen e projektit të përbashkët të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe Median në Evropën Jug-Lindore (JUFREX)”.

² Pika 2, faqe 7 e Kodit të Etikës së Gazetarit.

³ Në pikën 1, të nenit 9 të ligjit parashikohet se si rregull të dhënat sensitive nuk përpunohen, me përjashtim të rasteve kur përmbushet një nga kriteret e përcaktuara në pikën 2, të po këtij

neni. Në rastin e përpunimit të të dhënave sensitive nga gazetarët, germa “e” citon: “*është i nevojshëm për përmbushjen e një interesi publik thelbësor bazuar në legjislacionin në fuqi, i cili është proporcional me qëllimin e ndjekur, respekton thelbin e së drejtës së mbrojtjes së të dhënave*”.

⁴ Të dhënat personale, të cilat mund të shfaqin bindje racore, etnike, besimet fetare, filozofike apo të tjera, mendimet politike, anëtarësimin në parti, sindikata, shoqata ose organizata fetare, në jetën filozofike ose juridike, si dhe të dhënat e gjendjes shëndetësore dhe orientimit seksual. Parashikuar në pikën 28, të nenit 5 të ligjit.



personale. Pëlqimi nuk është i nevojshëm kur ekzistojnë rastet e kufizimeve të parashikuara në nenin 43 të ligjit, veçanërisht sa i përket përmbushjes së një interesi publik.

5. Gjatë raportimit mbi ngjarje që përfshijnë aksidente, fatkeqësi natyrore apo të shkaktuara nga njeriu, dhunë ndaj individëve, konflikte të armatosura ose skena vdekjeje, media ka përgjegjësinë të balancojë interesin publik për informim, me të drejtën e individëve për privatësi dhe dinjitet. Raportimi i plotë dhe i saktë nuk duhet të justifikojë cenimin e panevojshëm ose joproporcional të privatësisë së personave të përfshirë në ngjarje, që kanë të bëjnë me vuajtje, dhimbje ose tragjedi.

6. Media duhet të vlerësojë me kujdes justifikimin për qëllime gazetarie mbi përfshirjen e materialeve vizuale grafike ose invazive⁵. Vendimi për të publikuar pamje të tilla duhet të merret vetëm pasi të jenë shqyrtuar rrethanat konkrete dhe pasojat e mundshme për individët e përfshirë, si dhe ndikimi në të afërmit apo komunitetin më të gjerë.

7. Në raste emergjence ose fatkeqësie ku ekipet e medias arrijnë në vendngjarje, nën presionin e kohës dhe të situatës mund të ndodhë që të regjistrohet material në mënyrë të gjerë në pamundësinë e menjëhershme për të vlerësuar ndikimin në privatësi. Megjithatë, përpara çdo transmetimi apo publikimi të mëtejshëm të këtyre pamjeve, nga media duhet të bëhet një vlerësim i kujdesshëm për të shmangur ekspozimin e panevojshëm të vuajtjes, dhunës dhe cenimin e privatësisë së individëve⁶.

Neni 4

Familja, banesa, prona private

1. Çdo person ka të drejtë t'i respektohet jeta e tij/saj private dhe familjare, prona, shëndeti fizik e mendor dhe korrespondenca, duke përfshirë edhe komunikimin digjital.

⁵“**Invazive**” në kontekstin mediatik ose etik (si p.sh. “*materiale grafike ose invazive*”), mund të jetë: **ndërhyrëse** ose **cenuese**. Në varësi të kontekstit, **shqetësuese** (kur flitet për përmbajtje që ngjall tronditje emocionale), **të ekspozuara më tepër** (për përmbajtje që zbulojnë më shumë se sa është e nevojshme).

⁶ Praktikë e mirë mund të jetë, shmangia e identifikimit të viktimave pa pëlqimin e familjarëve; errësimi i fytyrave, mosshfaqja e plagëve apo e trupave pa jetë, si dhe shmangia e komenteve që gjenerojnë reagime emocionale ose nxitje të mëtejshme të dhunës, vuajtjes, etj.

2. Media nuk mund të ndërhyjë në jetën private të individit, pa pëlqimin e tij.

3. Nuk lejohen të publikohen imazhe të individit në vende private⁷, pa pëlqimin e tij.

4. Anëtarët e familjes, veçanërisht fëmijët, të afërmit dhe miqtë e figurave publike, të cilët vetë nuk janë figura publike, gëzojnë një nivel më të lartë të mbrojtjes së privatësisë. Vetëm në raste të veçanta, raportimi mediatik për ta mund të justifikohet nëse ekziston interes publik.

5. Adresa e banimit të një personi përbën të dhënë personale dhe, si e tillë, është e mbrojtur nga ligji. Në parim, ajo nuk duhet të publikohet nga media nëse nuk ka një interes publik.

6. Media në asnjë rast nuk mund të cenojë banesën apo të mbledhë imazhe nga një ambient privat, spitalor, apo institucion i vuajtjes së dënimit nëpërmjet kamerave, pa pëlqimin e personit. Mbrojtja e pronës dhe e ambienteve private shtrihet edhe në vende të tjera të kujdesit, ndalimit ose rehabilitimit, në përputhje me ligjin, duke përdorur në mënyrë korrekte teknikat ndërhyrëse.

7. Në rastin kur gazetarët mbledhin informacione nga institucione publike dhe private⁸ duhet të vlerësojnë, duke mbajtur parasysh rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, se cilat informacione mund të cenojnë dinjitetin dhe personalitetin e subjekteve të të dhënave, për të mos i publikuar. Në çdo rast, përgjegjësia e balancimit të interesave bie mbi redaktorin dhe median që publikon të dhënat.

Neni 5

Mbrojtja e të miturit⁹

1. Të miturit janë subjektet më të prekura ndaj rrezikut të cenimit të të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale. Media duhet të mbajë parasysh, që:

⁷ “*Vendet private*” janë pronë publike ose private, ku ekziston një besim i arsyeshëm për intimitetin.

⁸ Për shembull. Farmacitë mbledhin të dhëna personale të pacientëve dhe receta të lëshuara nga mjekët, bankat për klientët e tyre, kompanitë e sigurimit, kompanitë telefonike, policinë etj.

⁹ Shih ITA ER. neni 7 – Tutela del minore, dhe “*Carta di Treviso e Testo Unico dei Doveri del Giornalista*” në fuqi që nga 1 janari 2021 dhe aneksi 1 i tij “*Regole deontologiche relative al trattamento dei dati personali nell’esercizio dell’attività giornalistica*”.



a) të miturit duhet të jenë të lirë për të përfunduar aktivitetin shkollor, pa ndërhyrje të panevojshme në të dhënat e tyre personale;

b) fëmijët nën moshën 16 vjeç nuk duhet të intervistohen ose fotografohen, për çështje që përfshijnë mirëqenien (mbarëvajtjen) e tyre ose të një fëmije tjetër, vetëm kur prindi/kujdestari ligjor jep pëlqimin;

c) nxënësit nuk duhet të fotografohen apo intervistohen, në ambientet e shkollës pa siguruar më parë lejen e autoriteteve shkollore;

ç) media duhet të shmang publikimin e informacionit që ka lidhje me të dhënat personale të fëmijëve të figurave publike nëse informacioni nuk kontribuon në një debat me interes publik.

2. Me qëllim garantimin e interesit më të lartë të fëmijës, media ndalohet të publikojë gjeneralitetet, imazhet e të miturit, si dhe çdo të dhënë që mund të çojë në identifikimin e tij gjatë përfshirjes në një ngjarje kriminale. Mbrojtja e privatësisë së të miturit të përfshirë në një ngjarje kriminale garantohej në mënyrë proporcionale dhe rast pas rasti, duke vlerësuar ngjarjen në raport me interesin publik.

3. E drejta e fëmijës për ruajtjen e konfidencialitetit mbizotëron në raport me lirinë e shprehjes dhe publikimin e informacionit. Nëse, për arsye të një interesi publik dhe pa cenuar kufijtë ligjorë, media vendos të zbulojë informacione ose imazhe që kanë të bëjnë me të mitur, ajo duhet të ketë në konsideratë parësore, interesin më të lartë të fëmijës, si dhe të mos tejkalojë parashikimet e Kodit të Etikës së Gazetarit.

4. Media nuk duhet të identifikojë të miturit, të cilët janë viktimë ose dëshmitarë në rastet e krimeve seksuale.

5. Në çdo komunikatë për shtyp të një rasti që përfshin një krim seksual kundrejt një të mituri, duhet të shmanget zbulimi i marrëdhënies mes autorit dhe të miturit.

6. E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale të të miturit, veçanërisht kur kemi të bëjmë me një rast abuzimi ndaj tij, është parësore në krahasim me lirinë e shprehjes dhe publikimin e informacionit. Kjo vlen edhe në rastin kur identiteti bëhet i ditur nga burime zyrtare apo pranë familjes. Media nuk duhet të identifikojë viktimat e sulmeve seksuale apo

të botojë materiale që mund të çojnë në identifikim direkt ose indirekt të tyre.

7. Publikimi i të dhënave që lidhen me birësimin e të miturit, pa pëlqimin e prindit birësues, është i ndaluar. Përfshirja e prindit kur publikimi i të dhënave të të miturit të birësuar apo birësuesit vjen në interesin më të lartë të fëmijës.

8. Media duhet të garantojë anonimitetin e të miturit i cili është i përfshirë në një procedurë juridike, sidomos në çështje të natyrës familjare apo në raste të tjera delikate për shëndetin psikosocial të të miturit.

9. Media duhet të ketë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës, duke vlerësuar rast pas rasti marrëdhënien faktike që ka prindi me fëmijën, kryesisht sa i përket ushtrimit të drejtë të përgjegjësisë prindërore¹⁰. Informacionet e marra nga prindërit mund të publikohen vetëm kur shërbejnë në interesin më të lartë të fëmijës.

10. Nuk duhet të përdoren të miturit e sëmurë me patologji të rënda për qëllime propagandistike ose për çdo arsye tjetër që është në kundërshtim me të drejtat e tyre.

11. Nuk lejohet intervistimi i të miturit i cili ndodhet në kushtet e një gjendjeje të rëndë psikologjike¹¹ edhe nëse intervista paraqet interes publik. Të miturit nuk duhet të marrin pjesë në programet mediatike që trajtojnë dhe diskutojnë rreth ngjarjeve që shkaktojnë ngarkesë emocionale.

12. Media duhet të kërkojë pëlqimin e prindit apo kujdestarit ligjor për të intervistuar të miturit ose për t'i përfshirë ata në aktivitetet e tyre mediatike. Përfshirja mund të bëhet vetëm kur të miturve u jepet mundësia të flasin për tema që nuk janë të ndjeshme, dhe kur është e qartë që ata mund të shprehin pikëpamjet e tyre pa nevojën e pëlqimit të prindit/kujdestarit ligjor. Megjithatë, në çdo rast duhet mbajtur në konsideratë kundërshtimi i prindit/kujdestarit ligjor mbi informacionin e mbledhur përpara dhe nëse është publikuar pas publikimit.

¹⁰ Fëmija mund të jetë viktimë.

¹¹ Për shembull kur të miturit janë larguar nga banesa, kanë qenë viktimë të krimit të organizuar apo janë përdorur për prostitucion, etj.



Neni 6

Mbrojtja e të dhënave në procedimet penale

1. Përpunimi i të dhënave me qëllim për të zbuluar masat e sigurimit personal të caktuara ndaj personave të dyshuar për kryerjen e një vepre penale, lejohet vetëm kur ky përpunim është në përmbushje të interesit publik.

2. Në publikimin e informacionit të lidhur me një fakt penal, ndalohet identifikimi i personave të afërt me autorin e dyshuar ose të dënuar për kryerjen e veprës penale, me përjashtim kur këta të fundit kanë dhënë pëlqimin.

3. Me përjashtim të rasteve kur informacioni përbën interes publik, media nuk merr as prodhon imazhe të personave të ndaluar dhe/ose të arrestuar. Personat nuk duhen filmuar në kushtet e privimit të lirisë nga ana e organeve të rendit, përveç nëse kjo është e nevojshme për të raportuar veprime arbitrare nga organet e rendit.¹²

4. Respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë është pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Media, në publikimin e një fakti penal, ka detyrimin të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë.

5. Gjatë përpunimit për qëllime gazetarie të të dhënave personale që lidhen me persona të dyshuar për kryerjen e një vepre penale, persona të dënuar ose me subjekte të tjera të përfshira në një procedim penal, media ka detyrimin të respektojë të drejtën e tyre për një jetë private. Në mënyrë të veçantë kjo mbrojtje u garantohej të miturve, viktimave, dëshmitarëve, si dhe familjarëve të personave të dyshuar për kryerjen e një vepre penale ose të dënuar për kryerjen e një vepre penale.

6. Media mban në vëmendje pasojat e dëmshme që mund t'u vijnë personave të sipërpërmendur si rezultat i publikimit të informacionit që mund të çojë në zbulimin e identitetit të tyre.

Neni 7

Përdorimi i aparaturave për regjistrim

1. Media nuk duhet të përpunojë të dhëna personale apo të botojë/publikojë materiale të siguruar nga përdorimi i kamerave/pajisjeve të tjera të fshehta, apo nga thirrje private ose telefon celular, mesazhe/*email*, ose nëpërmjet përdorimit të

paautorizuar të dokumenteve dhe imazheve që përmbajnë të dhëna personale, përveç rasteve kur mbizotëron interesi publik.

2. Ndalohet publikimi tërësisht ose pjesërisht i dokumenteve të klasifikuara apo të konsideruara të tilla në kuptim të legjislacionit specifik në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Media gëzon të drejtën për të informuar mbi çështje me interes publik, por kjo e drejtë duhet ushtruar duke respektuar përmbajtjen thelbësore të informacionit, proporcionalitetin dhe domosdoshmërinë e publikimit, pa cenuar kufijtë e përcaktuar nga legjislacioni i posaçëm.

3. Publikimi i përmbajtjes së përgjimeve mund të konsiderohet proporcional nëse:

a) ndihmon në kuptimin e rrethanave të veçanta në të cilat ka ndodhur ngjarja dhe nuk tejkalon kufijtë e nevojshëm në raport me qëllimin informues dhe interesin publik të arsyeshëm;

b) nuk cenon asnjë dispozitë të legjislacionit në fuqi dhe hetimet paraprake apo gjykimin e një procedimi në zhvillim.

Në çdo rast, publikimi i materialeve të tilla duhet të bëhet duke respektuar të drejtat themelore të personave të përfshirë, bazuar në balancimin midis lirisë së shprehjes me mbrojtjen e jetës private.

4. Nuk lejohet publikimi i përmbajtjeve të përgjimeve që përfshijnë aspekte të jetës private që nuk lidhen me ngjarjen që përbën interes publik, veçanërisht të dhëna që kanë të bëjnë me intimitetin, marrëdhëniet familjare, shprehjet personale apo orientimin seksual të personave të përfshirë. Çdo tejkalim i këtyre kufijve përbën shkelje të parimit të proporcionalitetit dhe të minimizimit të të dhënave, siç përcaktohet në ligj dhe cenon të drejtën për jetë private të individëve të përfshirë.

5. Publikimet e pafiltruara mund të sjellin keqkuptime në interpretimin e fakteve apo marrëdhënieve ndërpersonale, si dhe të cenojnë të drejtën për privatesi, dinjitetin dhe zhvillimin e hetimeve penale.

6. Media gëzon të drejtën për të informuar mbi çështje me interes publik, por kjo e drejtë duhet ushtruar duke respektuar përmbajtjen thelbësore të informacionit, proporcionalitetin dhe domosdoshmërinë e publikimit.

¹² Shih nenin 8 Rregulla Etike ITA.



Neni 8

Mbrojtja e të dhënave shëndetësore

1. Të dhënat shëndetësore konsiderohen të dhëna sensitive dhe nuk mund të publikohen pa pëlqimin e subjektit, përveç rasteve kur personi nuk mund të identifikohet. Media ka detyrimin të respektojë dinjitetin dhe privatësinë e individit, veçanërisht në rastet e sëmundjeve të rënda, duke shmangur publikimin e detajeve të panevojshme. Publikimi i informacionit lejohet vetëm kur është i domosdoshëm për realizimin e qëllimit të informimit dhe gjithmonë duke ruajtur dinjitetin e personit, në përputhje me kufizimet e pikës 1, të nenit 10 të këtij udhëzimi, për individët me rëndësi të veçantë shoqërore ose publike.

2. Nuk lejohet publikimi i të dhënave të përfuara nga analizat dhe ekzaminimet shëndetësore, të cilat mund të tregojnë të dhëna sensitive mbi shëndetin. Ky publikim lejohet vetëm kur ndjek thelbin e informacionit dhe gjithmonë duke respektuar dinjitetin e personit.

Neni 9

Publikimi i imazheve

1. Gjatë dokumentimit me imazhe të fakteve të kronikës të cilat ndodhin në vende publike, media përpara publikimit të materialit duhet të vlerësojë se çfarë lloj fokusimi duhet përzgjedhur, duke shmangur fokusimin e pamjeve vetëm mbi individët apo tek detaje të personave, nëse përhapja e këtyre të dhënave nuk rezulton se ka lidhje ose e tejkalon qëllimin e kronikës.

2. Imazhet të cilat janë ekspozuar gjatë një konference për shtyp të mbajtur nga forcat e policisë apo të marra në mënyrë ligjore, nuk mund të shpërndahen, përveç se në ndjekjen e qëllimeve specifike për të cilat janë mbledhur në fillim (verifikim, parandalim ose ndalim të kryerjes së veprave penale).

3. Imazhet që dokumentojnë veprimet e arrestimit nuk mund të shpërndahen kur dëmtojnë dinjitetin e personit. Ndalohet riprodhimi i imazheve të personave të ndaluar, përveç kur kjo është në funksion të interesit publik. Faktet e tjera si ato që i përkasin arrestimit, hetimit dhe procesit (për shembull, imazhet e marra nga dokumentet e identifikimit, albumet familjare apo atyre të marra në seancë gjyqësore), duhet të përdoren në mënyrë të

ligjshme dhe korrekte. Përhapja e imazheve të cituara më sipër kryhet vetëm pasi është bërë një vlerësim për të dhënë vetëm thelbin e informacionit, në lidhje me lajmin.

4. Çdo ndërhyrje teknike mbi një imazh, përmes montazhit, korrigjimit elektronik apo përpunimit digjital, duhet të realizohet në mënyrë që të mos cenojë jetën private dhe dinjitetin e individit.

5. Imazhet nuk duhet të ekspozohen apo të vihen në shitje, për sa kohë që ekspozimi ose tregtimi mund të cenojë jetën private dhe dinjitetin e individit.

Neni 10

Figura publike

1. Media duhet të respektojë jetën private të figurave publike.

2. Publikimi i të dhënave personale nga media në lidhje me figura publike lejohet vetëm në atë masë që informacioni ka lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetin publik, veprimtarinë institucionale apo ndikimin e tyre në jetën publike. Ky publikim duhet të respektojë parimet e proporcionalitetit dhe interesit publik, sikundër parashikohet në ligj, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të të dhënave.

3. Ndalohet publikimi i informacioneve ose të dhënave që lidhen me jetën private të figurave publike, për sa kohë që këto të fundit nuk lidhen me aktivitetin publik të tyre.

Neni 11

Kuptimi i interesit publik

1. Për qëllimet e këtij udhëzimi, interesi publik lidhet me ato çështje që prekin publikun në një shkallë të tillë sa që ai ka të drejtë legjitime të interesohet dhe të informohet, me qëllim të kuptimit më të mirë të tyre dhe formimit të opinionit për vendime mbi ngjarje me rëndësi publike, ose që e shqetësojnë atë në mënyrë domethënëse.

2. Çështje që konsiderohen me interes publik janë, por pa u kufizuar, ato që lidhen me:

- a) ekspozimin e rasteve që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me mbrojtjen e sigurisë publike;
- b) mbrojtjen e shëndetit publik dhe mjedisit;
- c) parandalimin, ekspozimin e rasteve që kanë lidhje me veprat penale, krimet e rënda, trazirat, skandalet apo sjelljet dukshëm antisociale;



ç) të drejtat dhe liritë e tjera themelore të njeriut;
d) keqpërdorimin e detyrës publike ose përdorimin e papërshtatshëm/abuziv të fondeve publike;

dh) parandalimin publik të mashtrimit dhe/ose manipulimit;

e) parandalimin e keqinformimit të publikut nga deklaratat ose veprimet e individëve ose organizatave.

3. Media, ndër të tjera, në përcaktimin e interesit publik, duhet të ketë parasysh nëse publikimi i informacionit është në gjendje të kontribuojë në një debat publik me interes të përgjithshëm shoqëror.

4. Një informacion konsiderohet se kontribuon në debatin publik me interes të përgjithshëm kur lidhet me çështje që ndikojnë drejtpërdrejt në shoqëri, si funksionimi i institucioneve publike, ushtrimi i pushtetit, zbatimi i ligjit, mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, garantimi i transparencës dhe llogaridhënies, si edhe çështje në fushën shëndetësore, sociale, mjedisore ose ekonomike.

5. Informacioni që synon vetëm të kënaqë kuriozitetin ose të krijojë sensacion në publik për jetën private të individëve, nuk konsiderohet i përshtatshëm për publikim në kuadër të debatit publik me interes të përgjithshëm shoqëror, nuk lidhet me interesin publik dhe duhet shmangur, me qëllim respektimin e të drejtës për privatësi dhe dinjitetin e personave të përfshirë.

6. Gazetarët dhe media duhet të vlerësojnë rast pas rasti, në mënyrë të balancuar dhe proporcionale, nëse përmbajtja e publikimit përmbush kriteret e interesit publik, duke marrë parasysh natyrën e informacionit, mënyrën e marrjes së tij, rrethanat e rastit, statusin publik të personave të përfshirë dhe ndikimin që publikimi mund të ketë në debatin publik me interes të përgjithshëm shoqëror.

Neni 12

Arkiva

1. Arkiva e gazetarëve/medias, e cila përdoret për ushtrimin e veprimtarisë profesionale dhe ndjekjen për qëllime gazetarie, gëzon mbrojtje të posaçme, në lidhje me konfidencialitetin e burimeve të informacionit, në përputhje me ligjin.

2. Gazetarët/mediat kanë të drejtë të ruajnë të dhënat personale të mbledhura vetëm për kohën që është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit për të

cilin ato janë mbledhur, në përputhje me nenin 6 të ligjit, që parashikon parimin e kufizimit të afatit të ruajtjes.

3. Arkivat e gazetarëve/medias, përfshirë ato në formate fizike apo elektronike, përbëjnë burime me vlerë historike, sociale, shkencore dhe kulturore. Përpunimi i të dhënave personale që përfshihen në këto arkiva lejohet vetëm kur kryhet për qëllime historike, kërkimore, shkencore ose statistikore, në përputhje me nenin 45 të ligjit, duke marrë masa të përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave.

KREU II

AFATET DHE KUSHTET PËR PËRJASHTIMIN NGA DETYRIMET PËRKATËSE PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PËR QËLLIME GAZETARIE

Neni 13

E drejta për t'u harruar

1. Media, gjatë përpunimit të të dhënave personale në funksion të ushtrimit të veprimtarisë për qëllime gazetarie, respekton edhe të drejtën e individit për t'u harruar, si një e drejtë për të kërkuar fshirjen e të dhënave personale që nuk janë më të nevojshme, janë përpunuar në mënyrë të paligjshme ose që cenojnë jetën private dhe reputacionin e subjektit të të dhënave, në përputhje me ligjin.

2. Kërkesa për të drejtën për t'u harruar mund të paraqitet nga subjekti i të dhënave, kur:

a) informacioni i publikuar nuk është më i nevojshëm për qëllimet e gazetarisë për të cilat është mbledhur;

b) të dhënat kanë humbur vlerën aktuale për interesin publik dhe vijnë në kenë efekt negativ në jetën personale apo profesionale të individit;

c) informacioni është i pasaktë, i papërditësuar, i dëmshëm apo i panevojshëm në raport me kohën e kaluar nga ngjarja;

ç) subjekti i të dhënave ka ushtruar të drejtën për të tërhequr pëlqimin për përpunim, në rastet kur përpunimi është bazuar në pëlqimin e tij.

3. Media ka detyrimin të vlerësojë proporcionalitetin ndërmjet të drejtës për privatësi dhe të drejtës për liri të shprehjes dhe informim, duke marrë në konsideratë:

a) rolin publik të subjektit të të dhënave;



b) natyrën dhe ndjeshmërinë e informacionit të publikuar;

c) kohën e kaluar nga publikimi;

ç) qëllimin, formën dhe kontekstin e shpërndarjes së informacionit.

4. Kur informacioni është i disponueshëm *online* në arkivat e medias, masa për zbatimin e të drejtës për t'u harruar mund të përfshijë:

a) fshirjen e informacionit;

b) anonimizimin e emrit apo të të dhënave identifikuese;

c) de-indeksimin nga motorët e kërkimit;

ç) shtimin e një përditësimi ose reference ndaj zhvillimeve të mëvonshme ligjore që kanë ndryshuar statusin e subjektit të të dhënave.

5. E drejta për t'u harruar nuk zbatohet ndër të tjera nëse informacioni:

a) është i domosdoshëm për ushtrimin e së drejtës për liri të shprehjes dhe informimit;

b) ruan vlerë historike, shkencore ose hulumtuese për publikun;

c) është pjesë e një procesi penal apo gjyqësor në zhvillim ose që përfundon me një vendim përfundimtar të gjykatës;

ç) përmbush qëllime të interesit publik, përfshirë transparencën dhe llogaridhënien e figurave publike.

6. Në çdo rast, media është përgjegjëse për vlerësim objektiv dhe të paanshëm të kërkesave për fshirje dhe për marrjen e masave të arsyeshme për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të subjekteve të të dhënave.

Neni 14

Afatet dhe kushtet e përjashtimit

1. Veprimtaritë në fushën e gazetarisë konsiderohen si përpunime për qëllime të posaçme sipas pjesës së II, të kapitullit V, të ligjit.

2. Kontrolluesi përjashtohet nga detyrime specifike në kuptim të ligjit, kur përpunon të dhëna personale për publikimin e materialeve për qëllime gazetarie:

a) për përgatitjen e të cilave të dhënat në fjalë janë të domosdoshme për t'u përpunuar;

b) duke përpunuar të dhënat vetëm për qëllimin fillestar të parashikuar në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) pa cenuar thelbin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave;

ç) kur ka një interes publik;

d) kur zbatimi i dispozitave të ligjit e bën të pamundur arritjen e qëllimit.

3. Kur kontrolluesi mund të realizojë qëllimin e posaçëm edhe pa u bazuar në përjashtimet e përcaktuara në pikën më sipër, ai duhet të veprojë në mënyrën më pak ndërhyrëse në mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Kur kontrolluesi mbështetet në përjashtimet e nenit 43 të ligjit, ai duhet t'i ruajë të dhënat personale vetëm për atë kohë sa janë të nevojshme për të publikuar materiale për qëllime gazetarie. Këto të dhëna përhapen vetëm në rastet e parashikuara në pikën 2, të nenit 43, të ligjit.

5. Të dhënat personale mund të ruhen për periudha më të gjata vetëm për qëllime arkivimi dhe për sa kohë që ky përpunim është në shërbim të interesit publik dhe për qëllime kërkimore, shkencore, historike ose qëllime statistikore, duke iu nënshtruar zbatimit të masave të duhura teknike dhe organizative për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave. Përpunimi i mëtejshëm për qëllime arkivimi lejohet vetëm kur vjen në përputhje me pikën 3, të nenit 45 të ligjit dhe pikën 3, të nenit 12 të këtij udhëzimi.

Neni 15

Informimi dhe siguri i pëlqimit

1. Gazetari/media që përpunon të dhëna personale duhet të bëjë të njohur identitetin e tij si kontrollues, profesionin dhe qëllimin për të cilin mbledhet ky informacion, me përjashtim të rastit kur:

a) kjo sjell rrezik për sigurinë e tij; ose

b) njoftimi i subjektit e bën të pamundur ushtrimin e funksionit të tij.

2. Pas njoftimit të mësipërm, gazetari nuk i kërkohet të përmbushë elemente të tjera të informacionit të parashikuar në nenet 13 dhe 14, të ligjit, në përputhje me përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale të përcaktuar në nenin 6 dhe kufizimet e parashikuara në nenin 21, të ligjit.

Neni 16

Bashkëpunimi

Gazetari/media, në cilësinë e kontrolluesit, ka detyrimin ligjor të bashkëpunojë me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke i siguruar në këtë mënyrë



gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave që i ngarkon ligji.

Neni 17

Dispozitat përfundimtare

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjithë kontrolluesit/përpunuesit publikë dhe privatë në territorin e Republikës së Shqipërisë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e medias.

2. Mosrespektimi i kërkesave të këtij udhëzimi përbën shkelje të ligjit dhe sanksionohet sipas nenit 94, të tij.

3. Udhëzimi nr. 9/2010, “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, i ndryshuar dhe udhëzimi nr. 31/2012, “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Besnik Dervishi

UDHËZIM

Nr. 8, datë 20.11.2025

PËR KRITERET SHITESË PËR AKREDITIMIN E ORGANIZMAVE CERTIFIKUES

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 38, të pikës 1, të nenit 85 dhe pikës 2, të nenit 97, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZON:

KREU I

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i kriterëve shtesë për akreditimin e organizmave që do të kryejnë certifikimin, në përputhje me parashikimet e neneve 37 dhe 38, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

2. Kriteret shtesë plotësojnë kuadrin ligjor në fuqi dhe të gjitha së bashku përbëjnë mekanizmin certifikues.

3. Të gjitha kriteret dhe parashikimet e standardit ndërkombëtar ISO 17065 (vlerësimi i konformitetit – kriteret për organizmat e certifikimit të produkteve, proceseve dhe shërbimeve) janë të zbatueshme për efekt të akreditimit si organizëm certifikues.

4. Parashikimet e këtij udhëzimi nuk ndryshojnë apo prekin parashikimet e ligjeve të posaçme, rregulloreve apo akteve të tjera nënligjore të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit apo çdo organizëm kombëtar kompetent për akreditimin, që janë të zbatueshme krahas kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim.

Neni 2

Përkufizime

Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim si ato të parashikuara në ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe ISO 17065 (vlerësimi i konformitetit – kriteret për organizmat e certifikimit të produkteve, proceseve dhe shërbimeve). Shtohen në këtë udhëzim edhe përkufizimet e mëposhtme:

a) “Akreditim” është dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për organizmin certifikues, që përmbush kërkesat e përcaktuara në standardet e harmonizuara bazuar në procedurën dhe kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe kriteret shtesë të përcaktuara bazuar në nenin 38, të ligjit nr. 124/2024, “Për



mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe në këtë udhëzim;

b) “Organizëm certifikues” është çdo person juridik që kryen veprimtari të vlerësimit të konformitetit sipas akreditimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe të këtij udhëzimi;

c) “Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit” është organizmi kombëtar që kryen akreditimin e organeve të certifikimit dhe lëshon dëshminë/certifikatën përkatëse;

ç) “Mekanizëm certifikues” është tërësia e kriterëve dhe kompetencave strukturore, funksionale dhe operacionale të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve certifikuese që siguron koherencë, qëndrueshmëri dhe paanshmëri;

d) “Skemë certifikimi” nënkupton tërësinë e rregullave dhe procedurave të brendshme, hartuar dhe zbatuar nga organizmi i certifikimit që përfshin mënyrën e verifikimit të përputhshmërisë me kriteret e certifikimit dhe metodologjinë e vlerësimit për certifikimin e veprimtari(e) të përpunimit;

e) “Klient” nënkupton çdo kontrollues ose përpunues të të dhënave personale, që kërkon nga organizmi certifikues, certifikimin e veprimtari(e) përpunuese të të dhënave personale sipas parashikimeve të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe udhëzimit të Komisionerit nr. 9, datë 20.11.2025, “Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale” (në vijim udhëzimi nr. 9);

ë) “Komisioneri” nënkupton Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU II PROCEDURA E AKREDITIMIT

Neni 3 Parimet e akreditimit

1. Subjekti që synon të akreditohet si organizëm certifikues vërteton se ushtron veprimtarinë certifikuese në përputhje me këto parime:

a) paanësi dhe pavarësi, që nënkupton ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë të pavarur, të lirë nga ndikimet e papërshtatshme, si dhe garantimin e vendimmarrjes në mënyrë të paanshme në të gjitha veprimtaritë e certifikimit;

b) konfidencialitet, që nënkupton garancinë për marrjen e masave që parandalojnë aksesin e paautorizuar në informacionin e marrë në kuadër të veprimtarisë certifikuese, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj;

c) llogaridhënie, që nënkupton transparencë në vendimmarrjen, lidhur me certifikimin dhe në proceset certifikuese, me qëllim demonstrimin e përputhshmërisë me parashikimet ligjore;

ç) përgjegjësi, që nënkupton marrjen përsipër të përgjegjësisë për veprimtarinë e certifikimit, duke përfshirë përgjegjësinë ligjore që mund të lindë në kuadër të kryerjes së veprimtarisë certifikuese;

d) strukturë organizative të qartë dhe të dokumentuar që siguron funksionim efektiv të veprimtarisë certifikuese dhe përputhshmëri me standardet që zbatohen për këtë natyrë veprimtarie;

e) burime të nevojshme financiare dhe teknike, si dhe trajnim të vazhdueshëm të burimeve njerëzore për të kryer veprimtaritë certifikuese në përputhje me udhëzimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 9, datë 20.11.2025, “Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale”.

2. Zbatueshmëria e këtyre parimeve është objekt i monitorimit nga Komisioneri në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe këtij udhëzimi.

Neni 4 Akreditimi

1. Subjekti që synon të akreditohet si organizëm certifikues kryen procedurën e akreditimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

2. Akreditimi lëshohet për një afat maksimal prej 5 (pesë) vjetësh dhe mund të rinovohet me të njëjtat kushte si akreditimi fillestar.



Neni 5

Lista e dokumenteve për akreditim

1. Subjekti që synon akreditimin paraqet dokumentet e mëposhtme që vërtetojnë përmbushjen e kriterëve ligjore të parashikuara në nenin 38, pika 2, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe ato shtesë të përcaktuara në këtë udhëzim:

a) dokumente ose akte të autoriteteve vendase apo të huaja që vërtetojnë nivelin e duhur të njohurive, në lidhje me veprimtarinë e certifikimit, të vulave ose shenjave, si dhe zbatimin e mbrojtjes së të dhënave për veprimin përpunues, objekt certifikimi;

b) dokumente ose akte të brendshme të subjektit që vërtetojnë krijimin e Komitetit për Garantimin e Pavarësisë, miratuar nga organet e brendshme kompetente sipas statutit apo aktit të themelimit, që provojnë pavarësi dhe angazhim në ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave në mënyrë të tillë që nuk shkakton konflikt interesi sipas parashikimeve të këtij udhëzimi;

c) dokumente ose akte që demonstrojnë një skemë certifikimi, që konsiston në dokumentimin e kriterëve, procedurave ose protokolleve, që do të zbatohen për vlerësimin e veprimtari(e) të përpunimit të të dhënave personale, rishikimin periodik, pezullimin dhe shfuqizimin e certifikimit, vulave dhe shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale;

ç) dokumente ose akte të brendshme të subjektit që pasqyrojnë angazhim për të respektuar kriteret e certifikimit të përcaktuara në udhëzimin nr. 9 dhe mekanizmin e certifikimit, të miratuar nga organet përkatëse sipas statutit apo aktit të themelimit;

d) dokumente ose akte të brendshme të subjektit që përcaktojnë procedura dhe struktura përgjegjëse për shqyrtimin e ankesave për shkeljen e procedurës së certifikimit ose mënyrën sesi është zbatuar, ose po zbatohet certifikimi nga kontrolluesi ose përpunuesi, si dhe për t'i bërë këto procedura dhe struktura transparente për subjektet e të dhënave dhe publikun;

dh) model marrëveshjeje për certifikim që nënshkruhet midis organizimit certifikues dhe klientëve;

e) dokumente ose akte të brendshme që tregojnë angazhimin e subjektit që synon akreditim për ruajtjen e konfidencialitetit;

ë) dokumente ose akte që parashikojnë përputhshmërinë, lidhur me kërkesat për aksesin në informacion sipas nenit 11 të këtij udhëzimi;

f) dokumente ose akte që vërtetojnë përputhshmërinë me kriterin e përgjegjësisë, sipas nenit 12 të këtij udhëzimi;

g) dokumente ose akte që vërtetojnë përputhshmërinë me kriterin strukturor, sipas nenit 13 të këtij udhëzimi;

gj) dokumente ose akte që vërtetojnë përputhshmërinë në lidhje me burimet, sipas nenit 14 të këtij udhëzimi;

h) dokumente ose akte të autoriteteve vendase apo të huaja që vërtetojnë përshtatshmërinë teknike, aftësinë, certifikimin apo trajnimin e stafit;

i) dokumente ose akte të brendshme që tregojnë mënyrën e trajtimit dhe parandalimit të situatave të konfliktit të interesit;

j) dokumente ose akte të brendshme që përcaktojnë procedurën që do të ndiqet në rast shkeljeje të procedurës së certifikimit ose shkeljeve gjatë zbatimit të certifikimit nga ana kontrolluesit ose përpunuesit.

2. Parashikimet e pikës 1 të këtij neni nuk cenojnë të drejtën e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit për të kërkuar paraqitjen e dokumenteve të tjera, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

KREU III

KRITERET E AKREDITIMIT

Neni 6

Detyrimet ligjore të organizimit certifikues

1. Pavarësisht përmbushjes së kriterëve të parashikuara në pikën 4.1.1 të ISO 17065, organizmi certifikues, gjatë ushtrimit të veprimtarisë certifikuese zbaton procedura të përditësuara, në lidhje me përgjegjësitë ligjore sipas parashikimeve të këtij udhëzimi.

2. Organizmi i certifikimit zbaton procedura dhe masa për përpunimin e të dhënave personale të klientëve si pjesë e procesit të certifikimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Të dhënat për këto masa dhe procedura i vihen në dispozicion



Komisionerit për të verifikuar kontrollin dhe menaxhimin e të dhënave të klientit.

3. Organizmi i certifikimit njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit për çdo ndryshim thelbësor të rrethanave faktike apo ligjore që lidhen me certifikimin, menjëherë dhe në çdo rast jo më vonë se 15 ditë pas evidentimit të rrethanës. Rrethana thelbësore janë ato rrethana që ndikojnë në aftësinë e organizmit certifikues për të dhënë certifikime të besueshme dhe të arsyetuara, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm tek llogaridhënia, paanësia, kapaciteti financiar, konfidencialiteti, transparenca, kompetenca dhe trajtimi i menjëhershëm i ankesave.

4. Organizmi i certifikimit konfirmon që nuk ekzistojnë procedura ligjore që mund të rezultojnë në mospërputhshmëri me kriteret e akreditimit sipas nenit 38, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe këtij udhëzimi.

Neni 7

Marrëveshja e certifikimit

1. Përveç përmbylljes së kriterëve të parashikuara në pikën 4.1.2 të ISO 17065, marrëveshja e certifikimit e nënshkruar përkatësisht nga përfaqësuesit ligjorë të organizmit certifikues dhe klientit përfshin dhe përmban dakordësinë e palëve, në lidhje me këto aspekte:

a) përputhshmërinë me kriteret e certifikimit dhe zbatimin e çdo përditësimi që komunikohet nga organizmi certifikues;

b) dhënien e aksesit në informacion, dokumentacion, regjistra, pajisje, vendndodhje, personel ose informacion për kontraktorët apo nënkontraktorët e klientit në mënyrë që organizmi certifikues të kryejë procedurën e certifikimit, në përputhje me ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe parashikimet e udhëzimit nr. 9;

c) përmbylljen/përfundimin brenda afateve të procedurës së certifikimit të parashikuar në skemën përkatëse të certifikimit;

ç) njoftimin e organizmit certifikues për ndryshime thelbësore në statusin ligjor, veprimet e përpunimit të të dhënave personale, përputhshmërinë me kriteret e certifikimit ose informacionin mbi dokumentin formal të certifikimit. Ndryshime thelbësore të produktit, proceseve dhe shërbimeve janë ato që përbëjnë

ndryshime në objektin e certifikimit, pasi nënkuptojnë shtesa ose ndryshime thelbësore të objektit të certifikimit apo llojit të produktit, objektit të përpunimit dhe mënyrës së dhënies së shërbimeve;

d) bashkëpunimin për veprimtaritë monitoruese, auditimin periodik dhe masat korrigjuese që kërkojnë nga organizmi certifikues. Mospërmbyllja e këtij detyrimi passjell pezullimin apo shfuqizimin e certifikimit për subjektin që i nënshtrohet certifikimit, në përputhje me parashikimet e udhëzimit të Komisionerit nr. 9, datë 20.11.2025, “Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave”;

e) raportimin e menjëhershëm të çdo shkeljeje ligjore apo rregullatore që mund të passjellë mospërputhje me kriteret e certifikimit.

2. Marrëveshja e certifikimit përmban, gjithashtu, parashikime në lidhje me:

a) përgjegjësinë për klientin që certifikimi nuk i përjashton ata nga detyrimet ligjore sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale;

b) metodat e vlerësimit, ankesat dhe procedurat përkatëse, si dhe detyrimet ndaj klientit, në lidhje me këto procese që janë të përcaktuara nga organizmi i certifikimit, në përputhje me pikën 4.1.2.2 të ISO 17065 dhe parashikimet e këtij udhëzimi;

c) rregullat për vlefshmërinë, rinovimin, pezullimin dhe shfuqizimin e certifikimit, duke përfshirë rivlerësimin periodik në përputhje me pikën 4.1.2.2 të ISO 17065 dhe parashikimet e këtij udhëzimi;

d) pasojat e përfundimit të afatit, pezullimit, shfuqizimit apo moslëshimit të certifikatës, si dhe veprimet për të mbajtur ose rinovuar certifikimin.

Neni 8

Përdorimi i certifikatës, vulës dhe shenjës

1. Përveç përmbylljes së kriterëve të parashikuara në pikën 4.1.3 të ISO 17065, organizmi i certifikimit, nëpërmjet krijimit/hartimit të një mekanizmi të brendshëm, ruan kontrollin mbi përdorimin dhe ekspozimin e certifikatës, vulës dhe shenjës, si dhe çdo aspekti tjetër të certifikimit duke siguruar që:

a) mekanizmi i certifikimit është qartësisht i identifikueshëm. Komunikimet përshkruajnë në



mënyrë transparente objektin e veprimit(eve) përpunues/e që përfshihen në certifikim;

b) objekti i certifikimit është i përcaktuar qartë dhe shmang çdo keqinterpretim, në lidhje me veprimin(et) përpunues/e të vlerësuara në kuadër të procesit të certifikimit;

c) rregullat për përdorimin e vulës certifikuese zbatohen vetëm për klientët e certifikuar.

2. Çdo përdorim i pasaktë, çorientues apo që mund të keqinterpretohet i certifikatës, vulës ose shenjës, ose çdo aspekti tjetër të certifikimit, adresohet nëpërmjet instrumenteve korrigjuese të zbatueshme, që duhet të përfshijnë të paktën sa më poshtë:

a) kërkesën ndaj klientit për shmangien e praktikës së pasaktë apo që mund të shpjerë në keqinterpretim;

b) garantimin që klienti përditëson informacionin publik nëpërmjet mjeteve të komunikimit të ngjashme me ato që janë zbatuar më parë;

c) njoftimin e organizmit të certifikimit pa vonesë, në lidhje me mospërputhshmërinë dhe masat korrigjuese të ndërmarra.

3. Masa të tjera shtesë që vlerësohen nga organizmi i certifikimit mund të përfshijnë pezullimin ose shfuqizimin e certifikimit, publikimin e cenimit dhe nëse konsiderohet e nevojshme ndërmarrjen e procedurave ligjore.

Neni 9

Paanësia dhe pavarësia

1. Përveç përmbushjes së kriterëve të parashikuara në pikën 4.2 të ISO 17065, organizmi i certifikimit garanton paanësi dhe pavarësi në ushtrimin e veprimtarisë certifikuese nëpërmjet krijimit, organizimit dhe funksionimit të një komiteti të posaçëm, me pjesëmarrje të balancuar të përfaqësuesve të grupeve të interesit, duke siguruar që asnjë interes të mos mbizotërojë. Komiteti zhvillon takime periodike, të paktën një herë në vit, për të vlerësuar rreziqet lidhur me pavarësinë dhe efektivitetin e masave të zbatuara nga organizmi i certifikimit. Organizmi i certifikimit paraqet dokumente ose akte që vërtetojnë pavarësinë, veçanërisht sa i takon financimit duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në:

a) statutin dhe aktin e themelimit;

b) rregullat dhe procedurat e brendshme që lidhen me përbërjen, emërimin, shpërblimin dhe

kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të organizmit që kanë kompetenca vendimmarrëse mbi certifikimin;

c) dokumente që pasqyrojnë marrëdhëniet tregtare, financiare, kontraktuale ose të një natyre tjetër midis organizmit të certifikimit dhe klientëve, duke përfshirë pasqyrat financiare vjetore dhe evidentimin e burimeve të financimit.

2. Organizmi i certifikimit sigurohet që të mos mbajë marrëdhënie të çfarëdo lloji me klientin që është në proces vlerësimi. Veçanërisht, organizmi i certifikimit identifikon rreziqet e paanësisë dhe pavarësisë në mënyrë të rregullt dhe merr masa efektive për të mënjanuar rreziqet që rezultojnë nga veprime të palëve të treta, duke përfshirë individë, subjekte tregtare ose organe publike. Rreziku për paanësi dhe pavarësi përfshin kërcënimet që vijnë nga marrëdhënie financiare, tregtare, kontraktuale ose individuale.

3. Organizmi i certifikimit sigurohet për çdo klient që:

a) personeli i përfshirë në proces vlerësimi, shqyrtimi apo vendimmarrje të mos ketë marrëdhënie me klientin përtej veprimtarisë, në kuadër të procesit certifikues dhe nuk kryen veprime të tjera që mund të cenojnë paanësinë;

b) klienti nuk ka marrëdhënie familjare apo të një natyre tjetër që mund të përbëjë rrezik për paanësinë e organizmit të certifikimit;

c) nuk ekziston asnjë marrëdhënie financiare, përtej veprimtarisë në kuadër të procesit të certifikimit, midis organizmit të certifikimit dhe klientit. Organizmi i certifikimit dokumenton dhe menaxhon rrezikun për paanësinë.

4. Organizmi i brendshëm garanton që funksionet, detyrat dhe strukturat organizative të mos lenë vend për dyshime mbi konflikt interesi. Organizmi i certifikimit krijon dhe siguron zbatimin e një mekanizmi të brendshëm që garanton identifikimin, parandalimin dhe menaxhimin efektiv të konfliktit të interesit. Të gjithë punonjësit deklarojnë çdo konflikt aktual, të mundshëm apo të perceptuar të interesit sipas procedurave të brendshme të miratuara nga organi përkatës i organizmit të certifikimit. Konfliktet mund të lindin, por pa u kufizuar vetëm, në situatat e mëposhtme:

a) organizmi i certifikimit ka marrëdhënie financiare me klientin, që ushtron ndikim në të ardhurat ose influencë financiare;



b) organizmi i certifikimit ose punonjës të tij kanë kuota ose aksione në shoqërinë që jep shërbime konsulence, lidhur me produktet, proceset apo shërbimet që do të certifikohen;

c) organizmi i certifikimit nuk angazhohet në shërbime konsulence ose aktivitete të tjera që cenojnë paanësinë dhe pavarësinë, duke përfshirë por pa u kufizuar, veprimtarinë si nëpunës i mbrojtjes së të dhënave personale ose shërbime konsulence në lidhje me përputhshmërinë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Niveli drejtues dhe personeli përgjegjës i organizmit të certifikimit që angazhohet në vlerësimin e përputhshmërisë nuk duhet:

a) të ketë marrë pjesë në projektimin, prodhimin, shpërndarjen, instalimin apo blerjen e produktit, procesit ose shërbimit që i nënshtrohet vlerësimi;

b) të jetë zotërues, përdorues ose mirëmbajtës i produktit, procesit ose shërbimit në fjalë;

c) të veprojë si person i autorizuar i subjekteve që janë përfshirë në rolet e përmendura në pikën 5/“b” të këtij neni.

6. Organizmi i certifikimit zbaton procedura dhe mekanizma të brendshëm për identifikimin e vazhdueshëm dhe menaxhimin e rrezikut për paanësi dhe pavarësi, dhe sigurohet që i gjithë personeli të ruajnë pavarësinë dhe paanësinë në të gjitha aktivitetet certifikuese.

7. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 4.4 të ISO 17065, organizmi i certifikimit zbaton procedura certifikimit të drejta dhe jo diskriminuese, dhe siguron akses të barabartë në këto procedura certifikimi pavarësisht përmasave të klientit, përkatësisë, origjinës së produktit dhe siguron zbatueshmërinë e procedurës në mënyrë të barabartë tek të gjithë klientët.

Neni 10

Konfidencialiteti

1. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 4.5 të ISO 17065, organizmi i certifikimit është përgjegjës për administrimin e informacionit të mbledhur, krijuar ose përdorur në kuadër të veprimtarisë së certifikimit. Organizmi i certifikimit i garanton klientëve aktualë ose të ardhshëm që personeli i tij, veçanërisht ai i angazhuar në proces vlerësimi dhe vendimmarrjeje, ruan konfidencialitetin e informacionit nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve të konfidencialitetit,

vetëdeklarimeve ose dokumenteve të tjera me natyrë detyruese. Detyrimi përfshin të gjithë informacionin, pavarësisht natyrës sensitive, tregtare, pronësore, sekretin tregtar, procesin(et) tregtare, dokumentimin teknik dhe të dhënat personale, pa cenuar detyrimin e organizmit të certifikimit për të vepruar në përputhje me kuadrin ligjor për transparencë ose përmbushje të detyrimeve ligjore.

2. Detyrimi sipas pikës 1 të këtij neni nuk pengon organizmin e certifikimit të publikojë kriteret e certifikimit, metodologjinë dhe rezultatet e natyrës jokonfidenciale.

Neni 11

Llogaridhënia dhe aksesit në informacion

1. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 4.6 të ISO 17065, organizmi i certifikimit publikon dhe mundëson akses për publikun, në lidhje me:

a) të gjitha versionet (në fuqi dhe të shfuqizuara) e kriterëve të certifikimit, duke specifikuar periudhën e vlefshmërisë përkatëse;

b) procedurat e përditësuara të certifikimit duke përfshirë edhe atë për ankim;

c) informacion rreth procedurës së certifikimit që zbatohet në praktikë, duke përfshirë informacion për të dhënat e subjektit që preket nga përpunimi i të dhënave sipas objektit të certifikimit, si dhe mënyrën për të paraqitur dhe trajtuar ankesën;

ç) regjistër publik të vulave dhe shenjave të regjistruara.

Neni 12

Përgjegjësia

1. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 4.3 të ISO 17065, organizmi i certifikimit krijon dhe zbaton masa të përshtatshme, të tilla si sigurimi profesional ose rezerva financiare, për të mbuluar çdo përgjegjësi që rrjedh nga veprimtaritë certifikuese. Organizmi i certifikimit zbaton masa të përshtatshme për të siguruar mbulim tërësor të juridiksionit dhe përmbushja e këtij detyrimi është objekt verifikimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

2. Organizmi i certifikimit vërteton përmbushjen e detyrimit që lidhet me përgjegjësinë nëpërmjet dokumenteve/akteve ose vërtetimeve (polica sigurimi), si më poshtë:



a) sigurim profesional për mbulim të përgjegjësive që rrjedhin nga veprimtaritë e certifikimit;

b) nuk është në procedurë likuidimi ose falimentimi sipas legjislacionit në fuqi;

c) ka shlyer të gjitha detyrimet për kontributet shëndetësore dhe shoqërore sipas legjislacionit në fuqi;

ç) nuk është në procedurë ekzekutimi të detyrimeve tatimore;

d) përfaqësuesi ligjor nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale që lidhen me veprimtarinë e organizmit të certifikimit.

3. Organizmi i certifikimit kryen një vlerësim rreziku në lidhje me veprimtarinë certifikuese dhe zbaton masa të përshtatshme për të mënjeluar rreziqet e identifikuar, si dhe vendos në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit dhe Komisionerit dokumentacionin përkatës, nëse kërkohet. Rreziqet që lidhen me veprimtaritë e certifikimit mund të përfshijnë, por pa u kufizuar vetëm në sa më poshtë:

a) përcaktimin objektivave të auditit;

b) mënyrat e mbledhjes së të dhënave gjatë procesit të auditit;

c) rrezikun ekzistues dhe të perceptuar për paanshmërinë;

d) çështje që lidhen me përgjegjësinë dhe detyrimet ligjore, duke përfshirë përputhshmërinë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;

e) karakteristikat organizative dhe operative të klientit të audituar;

f) efektin e mundshëm të auditit te klienti dhe veprimtaritë që ushtron;

g) aspektet e shëndetit dhe sigurisë për ekipin auditues;

h) deklaratatë pasakta ose çorientuese të klientit;

i) përdorimi dhe mbrojtja e markave tregtare.

4. Masat e përshtatshme për të mënjeluar rrezikun e identifikuar mund të përfshijnë, ndër të tjera, edhe kontraktimin e policave të sigurimit që mbulojnë pretendime të mundshme, duke krijuar zëra buxhetorë të mjaftueshëm ose masa të ngjashme. Organizmi i certifikimit kryen vlerësime periodike të rrezikut, të paktën një herë në vit, për të identifikuar rreziqet që mund të vijnë ose ato që kanë ndryshuar, në lidhje me veprimtarinë dhe personelin.

Neni 13

Kriteret strukturore

1. Kriteret e parashikuara në pikën 5.1 të ISO/IEC 17065 zbatohen në lidhje me organizimin strukturor dhe nivelin e lartë drejtues.

2. Kriteret e parashikuara në pikën 5.2 të ISO/IEC 17065 zbatohen për mekanizmat që garantojnë paanësinë.

Neni 14

Burimet

1. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 6.1 të ISO 17065, organizmi i certifikimit krijon, zbaton dhe mban procedura drejtimi që vërtetojnë se personeli gëzon aftësitë, njohuritë dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer veprimtaritë e certifikimit. Informacioni mbi personelin përpunohet në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Organizmi i certifikimit siguron që personeli të ketë në përbërje individë me njohuri teknike dhe ligjore të nevojshme për procesin e certifikimit, përfshirë fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, rregullat që zbatohen për mbrojtjen e të dhënave të klientëve, masat teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe vlerësimin dhe auditimin e veprimeve të përpunimit të të dhënave.

2. Organizmi i certifikimit siguron dhe paraqet dokumentacionin e nevojshëm që vërteton njohuritë teknike të personelit, duke përfshirë:

a) diplomë në shkencat kompjuterike, sistemet e informacionit ose sigurisë kibernetike apo në fusha të ngjashme;

b) të paktën 5 vjet eksperiencë profesionale në mbrojtjen e të dhënave personale;

c) të paktën 2 ditë trajnim, në lidhje me menaxhimin e sigurisë së sistemit të informacionit, duke përfshirë rregullat, standardet, metodat, praktikat e mira dhe menaxhimin e rrezikut.

3. Organizmi i certifikimit siguron dhe paraqet dokumentacionin e nevojshëm që vërteton njohuritë ligjore të personelit, duke përfshirë:

a) diplomë në nivelin master ose kualifikim ekuivalent;

b) të paktën 5 vjet eksperiencë profesionale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.



4. Organizmi i certifikimit siguron forcim të vazhdueshëm të kapaciteteve të personelit nëpërmjet programeve të trajnimit profesional që përfshijnë standardet teknike, kriteret rregullatore dhe detyrimet, lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale. Trajnimi dhe përditësimi i njohurive/aftësive kryhet çdo vit dhe dokumentohet në mënyrë formale.

5. Organizmi i certifikimit siguron personel me njohuritë teknike dhe aftësitë/eksperiencën, si më poshtë:

a) për vlerësuesit, të paktën 2 vjet eksperiencë profesionale në fushën e të dhënave personale, përfshirë analizimin dhe zbatimin e masave teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, testime për sigurinë, vlerësime teknike ose certifikime;

b) për drejtuesit ose vendimmarrësit, të paktën 2 vjet eksperiencë profesionale në identifikimin, përcaktimin, monitorimin dhe këshillimin për masa të mbrojtjes së të dhënave personale.

6. Organizmi i certifikimit siguron personel me njohuritë ligjore dhe aftësitë/eksperiencën, si më poshtë:

a) për vlerësuesit, të paktën 2 vjet eksperiencë profesionale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, përfshirë analizimin ose zbatimin e përputhshmërisë së veprimeve të përpunimit të të dhënave personale, auditeve, ose rishikimit të kontratave;

b) për drejtuesit ose vendimmarrësit, të paktën 2 vjet eksperiencë profesionale në monitorim të përputhshmërisë ose këshillim në fushë e mbrojtjes së të dhënave personale.

7. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 6.2 të ISO 17065, në lidhje me pavarësinë nga interesat tregtarë apo interesa të tjerë me klientin, personeli i angazhuar në procesin e certifikimit vepron në përputhje me rregullat e miratuara nga organizmi i certifikimit.

8. Organizmi i certifikimit përdor informacionin për personelin për të identifikuar dhe mënjeluar rreziqet lidhur me paanësinë që rrjedhin nga veprimtaritë ose lidhjet institucionale. Të gjithë konfliktet e mundshme të interesit verifikohen dhe mënjanohen për të siguruar që personeli ruan pavarësinë nga interesat tregtarë ose interesa të tjerë me klientin.

9. Në rast se veprimtaritë e certifikimit kryhen nga subjekte të nënkontraktuara, organizmi i

certifikimit siguron që subjekti i nënkontraktuar dhe personeli i tij përmbushin kriteret e zbatueshme në lidhje me veprimtaritë e vlerësimit.

10. Në përputhje me pikat 6.2.24 dhe 7.6.1 të ISO 17065, organizmi i certifikimit mban përgjegjësi të plotë dhe përgjigjet për të gjitha aktivitetet e nënkontraktuara dhe siguron që subjekti i nënkontraktuar dhe personeli i tij të plotësojë të gjitha kriteret e zbatueshme, duke përfshirë parashikimet e ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe mbetet përgjegjës mbi vendimmarrjet që lidhen me certifikimin.

KREU IV

ZBATIMI I PROCESIT TË CERTIFIKIMIT

Neni 15

Zbatimi i ISO 17065

Kriteret e pikës 7.1 të ISO 17065 zbatohen në kuadër të procesit të certifikimit. Veprimi(et) e përpunimit të të dhënave personale vlerësohen sipas kriterëve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe këtë udhëzim.

Neni 16

Paraqitja e kërkesës nga klienti

1. Klienti paraqet pranë organizmit të certifikimit kërkesën me shkrim për vlerësim dhe certifikim. Kërkesa specifikon bashkëpunimin që mund të ekzistojë midis klientit dhe palëve të treta për kontrollin ose angazhimin e përpunuesve të të dhënave që do të jenë objekt i certifikimit. Në rast se klienti vepron si bashkëkontrollues ose bashkëpërpunues, kërkesa specifikon përgjegjësitë e klientit, detyrat dhe dokumentacionin kontraktual dhe ligjor mbi të cilat mbështetet bashkëpunimi.

2. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 7.2 të ISO 17065, klienti i paraqet organizmit të certifikimit informacionin, si më poshtë, në lidhje me vlerësimin:

a) përshkrim të detajuar të objektit të vlerësimit, duke përfshirë aspekte që lidhen me ndërfaqen me sisteme të jashtme ose subjekte të tjera, protokollet e zbatuara dhe garancitë për sigurinë e komunikimit të të dhënave;

b) listë të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave, duke përfshirë kuadrin ligjor të marrësit të



të dhënave dhe garancitë që janë zbatuar për mbrojtjen e tyre;

c) listë të përpunuesve të të dhënave ose nënpërpunuesve, duke përfshirë përgjegjësitë, veprimtaritë e përpunimit të të dhënave, kontratat kryesore ose model mbi të cilat bazohet marrëdhënia me klientin;

ç) listën e bashkëkontrolluesve, duke përfshirë përgjegjësitë dhe detyrat, si dhe parimet dhe instrumentet ligjore mbi të cilat bazohet marrëdhënia me klientin;

d) karakteristikat e përgjithshme të veprimeve të përpunimit të të dhënave që do të jenë objekt i certifikimit, duke përfshirë vendndodhjen fizike ku përpunohen të dhënat, kategorinë e të dhënave, si dhe detyrimet ligjore të zbatueshme;

dh) informacion mbi certifikimet ose rezultate të tjera të vlerësimeve që janë kryer më parë, në rast se ka pasur të tilla, dhe nëse natyra e këtyre vlerësimeve, si dhe objekti i tyre mund të konsiderohet në kuadër të procesit të certifikimit;

e) informacion në lidhje me hetime, sanksione të vendosura rishtazi ose masa korrigjuese të vendosura nga Komisioneri ose autoritete të tjera kompetente, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në kuadër të objektit të certifikimit;

ë) në rast se përpunimi i të dhënave personale mund të përbëjë rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e individit, të tilla si përpunimi i të dhënave sensitive ose përdorimi i teknologjive të avancuara ose procese vendimmarrëse automatike, klienti kryen dhe paraqet një vlerësim ndikimi në mbrojtjen e të dhënave në përputhje me nenin 31, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 17

Shqyrtimi i kërkesës për certifikim

1. Organizmi i certifikimit shqyrton kërkesën në përputhje me pikën 7.3 të ISO 17065 dhe parashikimet e pikës 2 të këtij neni.

2. Përveç përmbljes së kriterëve të parashikuara në pikën 7.3.1, organizmi i certifikimit vlerëson dokumentacionin e paraqitur dhe sigurohet që:

a) klienti të jetë kandidat i përshtatshëm për vlerësimin përkundrejt kriterëve të certifikimit duke pasur parasysh rregullat e përcaktuara në mekanizmin e certifikimit, si dhe verifikon që klienti dhe veprimet e përpunimit të të dhënave janë

brenda fushës së certifikimit, përgjegjësitë e klientit sipas kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale dhe llojet e veprimeve të përpunimit të të dhënave për të cilat janë miratuar kriteret e certifikimit;

b) ka metoda të përshtatshme vlerësimi për klientin, duke pasur parasysh rregullat e përcaktuara në skemën e certifikimit, kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale dhe çdo hetim në proces, sanksione të vendosura rishtazi ose masa korrigjuese të vendosura nga Komisioneri. Metodatat e vlerësimit zbatohen në klientë të ngjashëm për të prodhuar rezultate të krahasueshme;

c) ka njohuritë e nevojshme teknike dhe ligjore në mbrojtjen e të dhënave personale për të kryer veprimtaritë e certifikimit, veçanërisht në rast se nuk ka pasur eksperiencë të mëparshme në kryerjen e vlerësimeve me objekt të njëjtë ose të ngjashëm.

3. Në rast se skema e certifikimit përcakton rregulla për llogaritjen e kohëzgjatjes së veprimtarisë së certifikimit, organizmi i certifikimit zbaton një procedurë për të llogaritur kohëzgjatjen e vlerësimit, duke pasur parasysh:

a) shkallën e veprimeve të përpunimit të të dhënave që do të jenë objekt i certifikimit;

b) natyrën e të dhënave të përpunuara;

c) rreziqet për subjektet e të dhënave;

ç) kompleksitetin e teknologjive të përdorura;

d) angazhimin e përpunuesve të të dhënave;

e) numrin e vendeve ose strukturave në të cilat kryhet përpunimi i të dhënave të klientit.

4. Organizmi i certifikimit llogarit kohëzgjatjen e auditimit, në përputhje me skemën e certifikimit dhe përcakton nëse është e mjaftueshme për të përmbyllur vlerësimin ose nëse nevojitet kohë shtesë. Kohëzgjatja e auditit vendoset në marrëveshjen midis organizmit të certifikimit dhe klientit.

5. Organizmi i certifikimit siguron që marrëveshja e certifikimit të përmbajë metodologjinë e detyrueshme të vlerësimit të klientit dhe që vlerësimi të përfshijë në mënyrë të arsyeshme kompetencat teknike dhe ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Posedimi i këtyre kompetencave vlerësohet i përmbushur kur personeli i angazhuar në procesin e certifikimit përmbush kriteret teknike dhe ligjore të parashikuara në nenin 14 të këtij udhëzimi, duke përfshirë dokumentimin, lidhur me formimin dhe eksperiencën profesionale, si dhe ndjekjen e trajnimeve të vazhdueshme.



6. Organizmi i certifikimit ruan regjistrat që vërtetojnë kompetencat dhe verifikon përmbushjen e kriterëve për të gjithë personelin, duke përfshirë, sipas rastit, edhe ato për vlerësuesit e nënkontraktuar.

Neni 18

Plani i vlerësimit

Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 7.4 të ISO 17065, organizmi i certifikimit harton dhe zbaton një plan vlerësimi që parashikon zbatimin e metodologjisë së vlerësimit të parashikuar në marrëveshje. Metodologjia mund të përfshijë vlerësime në terren, dokumentare, kryerjen e auditeve, intervistave ose zbatimin e instrumenteve të tjera të përshtatshme për të mbledhur gjetje që vërtetojnë plotësimin e kriterëve të vlerësimit. Plani i vlerësimit përmban një vlerësim rreziku dhe vlerësimin e ndikimit në mbrojtjen e të dhënave për veprime përpunimi me rrezik të lartë për liritë dhe të drejtat themelore të individëve.

Neni 19

Metodologjia e vlerësimit

1. Devijimi nga metodologjia e vlerësimit dokumentohet duke parashtruar arsyet, vlerësimin e rrezikut dhe efektet e gjetjeve që janë me vlerë për certifikimin.

2. Organizmi i certifikimit siguron që metodologjia e vlerësimit të jetë e përshtatshme për të vlerësuar përmbushjen e kriterëve të certifikimit, e standardizuar dhe e zbatueshme. Metodologjia e vlerësimit përfshin respektimin e kriterëve ligjorë të certifikimit të përmendura në këtë udhëzim. Organizmi i certifikimit siguron dokumentimin dhe ruajtjen e metodologjisë së zbatuar dhe rezultateve përkatëse. Metodologjia e vlerësimit përshtatet për tipologjinë, kompleksitetin dhe nivelin e rrezikut të veprimeve të përpunimit për të siguruar që përpunimi me rrezik të lartë të vlerësohet në mënyrë të plotë.

3. Detyrat lidhur me vlerësimin mund t'i caktohen personelit të brendshëm ose ekspertëve të jashtëm të miratuar nga organizmi i certifikimit, me kusht që ekipi i angazhuar në vlerësim të përmbushë kriteret për njohuritë ligjore dhe teknike të përmendura në nenin 14 të këtij udhëzimi. Organizmi i certifikimit siguron që klienti të

plotësojë kriteret e mekanizmit të certifikimit, në rast se i bëhet referencë rezultateve të mëparshme të certifikimit. Raportet e mëparshme të vlerësimit janë të aksesueshme dhe gjetjet e tjera dokumentohen.

4. Në përputhje me kriteret e pikës 7.5 të ISO 17065, organizmi i certifikimit vlerëson të gjithë informacionin dhe rezultatet e vlerësimit. Procesi i vlerësimit siguron përputhshmëri midis objektit të certifikimit dhe objektit të vlerësimit, dhe që metodologjia e vlerësimit është zbatuar në mënyrë koherente përkundrejt gjetjeve të dokumentuara.

Neni 20

Informimi i klientit

1. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 7.4.6 të ISO 17065, organizmi i certifikimit përcakton procedurat për informimin e klientit, në lidhje me rezultatet e vlerësimit, duke përfshirë mospërputhshmëritë dhe duke specifikuar llojin, formën dhe afatin kohor në përputhje me skemën e certifikimit.

2. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 7.4.9 të ISO 17065, gjetjet e vlerësimit dokumentohen për çdo kriter vlerësimi në përputhje me skemën e certifikimit. Dokumentet e mbledhura gjatë vlerësimit evidentohen në mënyrë të qartë në mënyrë që të krijohet lidhja me kriterin përkatës të certifikimit dhe gjetjet përkatëse. Klienti ftohet të propozojë masa korrigjuese dhe parandaluese që i bashkëngjiten planit të veprimit dhe që verifikohen përpara marrjes së vendimit të certifikimit. Raporti i vlerësimit përmban:

a) një përshkrim të klientit;
b) planin e vlerësimit;
c) referenca për dokumentet e shqyrtuara;
ç) referencat në veprimet e përpunimit që janë vlerësuar;

d) funksionet e personave të intervistuar, vendndodhjen e gjetjeve, përshkrim të mospërputhshmërisë duke përfshirë shkallën dhe përmasën;

dh) organizmi i certifikimit përcakton, zbaton dhe mban një metodologji formale vlerësimi që specifikon qasjen, kriteret, afatet kohore dhe rregullat e vendimmarrjes që përcaktojnë përmbushjen e çdo kriteri të certifikimit. Metodologjia zbatohet në mënyrë koherente për klientin dhe dokumentohet në planin dhe raportet e vlerësimit.



Neni 21

Aksesi në raportet e vlerësimit

1. Raportet e vlerësimit dhe anekset përkatëse janë plotësisht të aksesueshme me kërkesë nga Komisioneri dhe ruhen për një periudhë kohore 6-vjeçare.

2. Komisioneri mund të marrë pjesë si vëzhgues gjatë kryerjes së procedurës së vlerësimit.

KREU V

**VENDIMI PËR CERTIFIKIMIN,
MONITORIMIN DHE RINOVIMIN E
CERTIFIKIMIT**

Neni 22

Vendimi për certifikimin

1. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 7.6 të ISO 17065, organizmi i certifikimit përcakton dhe zbaton procedura që sigurojnë pavarësinë dhe llogaridhënien, në lidhje me vendimin për certifikim. Procedurat vendimmarrëse përfshijnë analizën e rrezikut dhe sigurojnë që vendimi të mbështetet në dokumente dhe prova.

2. Personi(at) apo ekipi përgjegjës për vendimin e certifikimit nuk duhet të kenë marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në aktivitetet vlerësuese ose këshilluese për të njëjtin klient dhe duhet të nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit. Kur është e nevojshme, me qëllim ruajtjen e pavarësisë, zbatohet rotacion i personelit.

3. Organizmi i certifikimit dokumenton dhe ruan të gjitha vendimet për certifikim, duke përfshirë arsyetimin, dokumentacionin provues dhe identifikimin e personave vendimmarrës, si dhe krijon mekanizëm të brendshëm për vlerësim dhe shqyrtim të ankesave.

Neni 23

Dokumenti që vërteton certifikimin

1. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 7.7 të ISO 17065, organizmi i certifikimit i dorëzon klientit një dokument formal (certifikatë) nëpërmjet të cilës identifikohet:

a) emri i plotë dhe versioni i kriterëve të certifikimit që janë përdorur për vlerësimin;

b) objekti i certifikimit, duke përfshirë një parashtrim (formulim) të qartë dhe të kuptueshëm të objektit të certifikimit, përshkrimin e llojit të të dhënave personale, veprimet përpunuese të përfshira dhe një listë me vendndodhjet ku kryhen këto veprime përpunimi;

c) klienti, përfshirë numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS).

2. Periudha e vlefshmërisë së certifikimit nuk mund të tejkalojë 3 vite. Monitorimi periodik i certifikimit kryhet dhe dokumentohet në përputhje me nenin 25 të këtij udhëzimi.

3. Në rast ndryshimesh ligjore ose rregullatore që ndikojnë në përputhshmërinë e klientit, organizmi i certifikimit siguron, brenda një afati të arsyeshëm, përditësimin e certifikatës dhe dokumenteve të tjera.

Neni 24

**Detyrimi për publikimin e raportit të
vlerësimit**

1. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 7.8 të ISO 17065, organizmi i certifikimit ruan informacionin e klientit të certifikuar, duke mundësuar akses nëpërmjet faqes zyrtare të internetit në një përmbledhje (ekstrakt) të këtij informacioni. Përmbledhja (ekstrakti) i raportit të vlerësimit përmban të dhënat e mëposhtme:

a) objektin e certifikimit, duke përfshirë një parashtrim të qartë dhe të kuptueshëm të objektit të certifikimit dhe çdo veprimi përpunimi të të dhënave personale që përfshihen në certifikim;

b) kriteret përkatëse të certifikimit, duke përfshirë versionin, statusin dhe referencat e zbatueshme tek standardet e njohura ose rregullat e tjera referuese;

c) metodat e vlerësimit dhe testet e kryera;

ç) rezultatet, duke përfshirë mospërputhshmërinë, kufizimet e vlerësimit dhe rreziqet e identifikuar të paadresuara.

2. Përmbledhja (ekstrakti) vlerësohet dhe përditësohet të paktën një herë në vit ose kur ka ndryshime thelbësore në objekt, kriteret, metodologjinë e vlerësimit, rreziqet e paadresuara, duke siguruar që informacioni të mbetet i saktë, i plotë dhe i përditësuar.



Neni 25

Detyrimi për zbatimin e masave të monitorimit

1. Organizmi i certifikimit zbaton masa monitoruese gjatë të gjithë vlefshmërisë së certifikimit për të verifikuar përputhshmërinë e vazhdueshme me kriteret e certifikimit, duke siguruar që objekti, periodiciteti dhe intensiteti i monitorimit të jetë në proporcion me rreziqet e vlerësuara për subjektet e të dhënave dhe mundësinë e mospërputhjeve.

2. Veprimtaritë e monitorimit planifikohen dhe zhvillohen bazuar në vlerësimin e rrezikut, rreziqet që lidhen me klientin dhe veprimet e përpunimit të certifikuar. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 7.9 të ISO 17065, monitorimi përfshin vlerësimin e aspekteve të mëposhtme:

a) ndryshimin e veprimeve të përpunimit të të dhënave që nga momenti i vlerësimit të fundit;

b) zbatimin e kriterëve të vlerësimit që janë shtyrë më parë;

c) masat korrigjuese nga audite të mëparshme; dhe

ç) kriteret e përzgjedhura bazuar në rrezikun e evidentuar për mospërputhshmëri.

3. Procedura e monitorimit është transparente, efektive, e verifikueshme dhe nga pikëpamja operative, e zbatueshme dhe e përshtatshme për skemën e certifikimit. Procedurat e monitorimit janë të pavarura nga ndikime operative apo tregtare që mund të cenojnë paanshmërinë. Këto procedura përfshijnë:

a) përcaktimin e përgjegjësive, strukturës dhe burimeve të caktuara për monitorim;

b) aktivitete periodike monitorimi që mund të përfshijnë inspektim, audit ose vlerësime të ngjashme;

c) mekanizmin për të vlerësuar nëse kriteret për mbajtjen e certifikimit vijnë të konsiderohen të plotësuar;

ç) vlerësime shtesë që vijnë nga ankesat, mospërputhshmëria që është evidentuar publikisht ose udhëzime nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit apo nga Komisioneri.

4. Organizmi i certifikimit, për efekt transparence, publikon regjistrin e përditësuar, lidhur me statusin e certifikimit (vlefshmërinë, pezullimin apo shfuqizimin).

5. Të gjitha aktivitetet e monitorimit, vlerësimit të rrezikut, masave korrigjuese dhe vendimet përkatëse dokumentohen për të siguruar gjurmueshmëri, llogaridhënie dhe transparencë në përputhje me ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe aktet nënligjore përkatëse.

Neni 26

Ndryshime që ndikojnë në certifikim

1. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 7.10 të ISO 17065, organizmi i certifikimit konsideron si ndryshime që ndikojnë në certifikim:

a) çdo ndryshim në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale përkundrejt objektit të mekanizmit të certifikimit;

b) vendimet e Komisionerit, në lidhje me objektin e mekanizmit të certifikimit;

c) vendime të gjykatës që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale për çështje të paraqitura për shqyrtim në raport me objektin e certifikimit;

ç) zhvillime të reja teknologjike që përdoren për veprimet e përpunimit të të dhënave;

d) rreziqe të reja për mbrojtjen e të dhënave personale duke përfshirë identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të reja ose që po evoluojnë nga inovacioni në teknologji, ndryshime në praktikat e përpunimit të të dhënave ose zhvillime të tjera që mund të ndikojnë në efektivitetin e procesit të certifikimit dhe zbatimin e masave teknike, dhe organizative për të zvogëluar këto rreziqe.

2. Ndryshimet mund të menaxhohen nëpërmjet procedurave të posaçme, duke përfshirë periudha tranzitore, rivlerësime të klientit, dhe nëse konsiderohet e përshtatshme edhe masa për shfuqizimin e certifikimit në rast se përpunimi nuk përmbush kriteret e përditësuar.

Neni 27

Përfundimi, pezullimi dhe shfuqizimi i certifikimit

1. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 7.11 të ISO 17065, organizmi i certifikimit harton dhe zbaton procedura për të njoftuar menjëherë me shkrim klientin, Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit dhe Komisionerin për çdo vendim certifikimi, që lidhet me vlefshmërinë, reduktimin e objektit, pezullimin ose shfuqizimin e tij, duke përfshirë vendimet që merren si pasojë e ankesave:



a) në rast përfundimi me kërkesë nga klienti, organizmi i certifikimit informon Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit dhe Komisionerin, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e marrjes së kërkesës, për përfundimin e certifikimit;

b) në rast të vendosjes ose heqjes së pezullimit, shfuqizimit ose reduktimit të objektit, organizmi i certifikimit informon pa vonesë Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit dhe Komisionerin.

2. Organizmi i certifikimit përcakton procedurat për trajtimin e mospërputhshmërisë së klientit sipas rregullave të përcaktuara në skemën e certifikimit, që përfshin të paktën aspektet e mëposhtme:

a) përcakton nëse masat korrigjuese të propozuara nga klienti janë të përshtatshme për të adresuar problemin, përpara se të merret vendimi mbi certifikimin. Për të gjithë mospërputhshmëritë, organizmi i certifikimit vlerëson nëse plani i veprimit është i përshtatshëm për të siguruar përpqutshmëri me veprimet e përpunimit të të dhënave, përpara se të merret vendimi mbi certifikimin. Në rast se një plan veprimi nuk është i përshtatshëm për të siguruar përpqutshmëri, organizmi i certifikimit pezullon vendimin për certifikim derisa të paraqiten prova për zbatimin e masave korrigjuese;

b) përcakton vonesat në zbatimin e masave korrigjuese (plan veprimi) nga 30 deri në 60 ditë duke pasur parasysh shkallën dhe natyrën e mospërputhshmërisë;

c) në rast se certifikimi është i kushtëzuar nga zbatimi i planit të veprimit, organizmi i certifikimit verifikon masat korrigjuese që janë zbatuar dhe ndërmerr veprimet e nevojshme në rast se mospërputhshmëria me kriteret nuk është adresuar sipas planit të veprimit.

3. Organizmi i certifikimit zbaton aktet me karakter detyrues të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit dhe Komisionerit, duke përfshirë revokimin, pezullimin dhe refuzimin e certifikimit në rast se konstatohet që kriteret nuk përmbushen.

4. Në rast se vendoset refuzim, pezullim ose shfuqizim i certifikimit, klienti informohet për të drejtën për t'u ankuar, lidhur me vendimin, mjetet në dispozicion, si dhe afatet përkatëse.

Neni 28

Dokumentimi

1. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 7.12 të ISO 17065, organizmi i certifikimit mban

dokumentacionin në mënyrë të plotë, të kuptueshme, të përditësuar dhe të verifikueshme.

2. Dokumentacioni duhet të përfshijë të paktën sa më poshtë:

a) dokumente që lidhen me certifikimin(et) që është/janë dhënë ose vendimet për refuzim;

b) dokumente që lidhen me procedurat në shqyrtim për certifikim.

3. Dokumentacioni është i aksesueshëm për një periudhë 6-vjeçare. Në rast mosmarrëveshjeje midis organizmit të certifikimit dhe klientit ose në rast ankese, afati i ruajtjes së dokumentacionit për efekt të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, përcaktohet nga rregullat e zbatueshme të mosmarrëveshjes.

Neni 29

Ankimi

1. Organizmi i certifikimit garanton mekanizma ankimi për çdo subjekt të të dhënave ose organizatë aktive në mbrojtjen e të dhënave personale, të autorizuar nga një subjekt të dhënash, në lidhje me veprimtaritë e certifikimit, pa paragjykuar të drejtën e subjekteve të të dhënave për të paraqitur ankim pranë Komisionerit ose padi në gjykatë.

2. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 7.13 të ISO 17065, organizmi i certifikimit zbaton një procedurë të dokumentuar që përfshin marrjen, shqyrtimin dhe vendimmarrjen mbi ankimin, në lidhje me procesin e certifikimit, duke pasur parasysh rregullat e parashikuara në skemën e certifikimit. Procedura është e aksesueshme për publikun dhe për të gjitha subjektet e të dhënave, si dhe organet kompetente brenda objektit të certifikimit.

3. Procedura e trajtimit të ankimit siguron pjesëmarrje, paanësi dhe të drejtën për t'u dëgjuar. Ankuesi informohet mbi ecurinë dhe vendimmarrjen brenda një afati të arsyeshëm, por jo më vonë se 3 muaj nga data e paraqitjes së ankesës. Vlerësimi paraprak mbi ankesën dërgohet brenda një muaji nga data e paraqitjes së ankimit që parashtron përgjigjen paraprake dhe hapat që do të ndiqen në 2 (dy) muajt e ardhshëm. Në rast se nuk mund arrihet në një vendimmarrje formale brenda afatit 3-(tre-)-muajor, organizmi i certifikimit informon ankuesin mbi përfundimin e procesit dhe arsyet pse nuk ka qenë e mundur arritja e një përfundimi brenda këtij afati.



4. Procedura e ankimit duhet të paktën të përfshijë sa më poshtë vijon:

a) subjektet që legjitimohen të paraqesin ankim;

b) subjektin përgjegjës për të mbledhur dhe verifikuar informacionin e nevojshëm për ecurinë e ankimit deri në vendimmarrje;

c) subjektin përgjegjës për vendimmarrjen dhe zgjidhjen e ankimit;

ç) fazat e ndryshme për informimin e ankuesit, në lidhje me ecurinë, rezultatin dhe përmbylljen e ankimit, duke përfshirë afatet kohore përkatëse;

d) mënyrën se si kryhet verifikimi;

dh) procedurën që mund të ndërmerret për të zgjidhur ankimin, duke përfshirë konsultimet me aktorët e përfshirë;

e) palëve që iu dërgohet konfirmimi i njoftimit, brenda 1 (një) muaji nga marrja, që mund të zgjatet nëse është e nevojshme dhe në mënyrë të arsyetuar edhe 1 (një) muaj;

ë) afatet kohore për të cilat pala duhet të jetë në dijeni;

f) procedurat e tjera në rast se çështja (ankimi) mbetet e/i pazgjidhur apo papërfunduar.

5. Organizmi i certifikimit siguron që trajtimi i ankesës të jetë i ndryshëm nga ai i vlerësimit, shqyrtimit dhe vendimmarrjes mbi certifikimin, me qëllim mënjanimin e konfliktit të interesit.

6. Organizmi i certifikimit krijon dhe përditëson regjistrin e ankesave që duhet të përfshijë:

a) ecurinë e çdo ankesë (depozituar, në hetim ose përfunduar);

b) datat e veprimeve të ndërmarra (regjistrim ankimi, marrje dijeni, përditësim mbi ecurinë, vendimmarrjen etj.).

7. Regjistri është i aksesueshëm për inspektime nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, si dhe Komisioneri.

KREU VI KRITERET PËR SISTEMIN E MENAXHIMIT

Neni 30

Kriteret e përgjithshme të sistemit të menaxhimit

1. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 8 të ISO 17065, organizmi i certifikimit zhvillon dhe mirëmban një sistem menaxhimi që përmbush kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim për të gjithë

veprimtaritë e certifikimit dhe brenda objektit të akreditimit. Sistemi përfshin dokumentimin, vlerësimin dhe monitorimin e pavarur të kriterëve shtesë për të siguruar përputhshmëri, transparencë dhe gjurmueshmëri.

2. Sistemi i menaxhimit bazohet në një metodologji për zbatimin dhe kontrollin e kriterëve, në përputhje me ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe këtë udhëzim, duke përfshirë monitorimin e vazhdueshëm për të siguruar përputhshmëri. Sistemi harmonizohet me parimet e përgjithshme të menaxhimit të ISO 17065, dokumentimin dhe kontrollin, raportet e auditëve të brendshme, vlerësimet e organeve drejtuese, si dhe masat korrigjuese dhe parandaluese.

3. Veçanërisht, sistemi i menaxhimit siguron:

a) informacion mbi certifikimin, duke përfshirë mekanizmin e certifikimit ose skemën e zbatuar, periudhën e vlefshmërisë, si dhe kushtet përkatëse që janë të aksesueshme për publikun në mënyrë të përhershme dhe të vazhdueshme. Informacioni përditësohet rregullisht, në lidhje me ndryshime të skemës së certifikimit ose vendimmarrje të tjera përkatëse;

b) përmbushjen e kriterëve të neneve 11 dhe 24 të këtij udhëzimi;

c) se zbatimi i parimeve të menaxhimit është transparent dhe vërtetohet gjatë procesit të akreditimit ose me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit ose Komisionerit;

ç) se sistemi i menaxhimit është në përputhje me këto kriterë:

i. pikën 8.2 të ISO 17065, në lidhje me dokumentimin e sistemit të menaxhimit, duke përfshirë procesin e hartimit, përditësimin dhe ruajtjen e dokumenteve sipas ndryshimeve ligjore dhe standardeve. Dokumentacioni është i aksesueshëm për të gjitha palët e interesuara, për sa kohë ruhet konfidencialiteti dhe integriteti i të dhënave;

ii. pikën 8.3 dhe 8.4 të ISO 17065, lidhur me kontrollin e dokumenteve për të siguruar që i gjithë dokumentacioni të jetë i arkivuar në përputhje me elementet e sigurisë dhe i përditësuar. Ndryshimet në dokumentacion monitorohen dhe auditohen për të siguruar saktësi dhe përputhshmëri të të dhënave;

iii. pikën 8.5 të ISO 17065, në lidhje me vlerësimin e nivelit drejtues, duke përfshirë analizën e rezultateve të auditit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm. Vlerësimi kryhet rregullisht dhe është



pjesë e procesit të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit;

iv. pikën 8.6 të ISO 17065, në lidhje me auditin e brendshëm. Auditin kryhet në mënyrë të dokumentuar dhe përfshin të gjitha aspektet e sistemit të menaxhimit, duke përfshirë cilësinë, përputhshmërinë rregullatore dhe sigurinë e të dhënave. Auditorët janë të pavarur nga departamentet që auditohen dhe kanë kryer trajnimet përkatëse. Rezultatet e auditit dokumentohen dhe përfshijnë rekomandime specifike për përmirësim dhe plan veprimi të detajuar për zbatimin e tyre;

v. pikën 8.7 të ISO 17065, në lidhje me masat korrigjuese të ndërmarra për të adresuar mospërputhshmëritë e evidentuara. Masat korrigjuese përfshijnë një analizë dhe janë objekt i vlerësimit nga auditin e brendshëm. Ato monitorohen dhe zbatohen brenda një periudhe kohore të caktuar. Organizmi i certifikimit raporton mbi progresin e zbatimit të këtyre masave dhe siguron që efektet të jenë matshme dhe vlerësueshme;

vi. pikën 8.8. të ISO 17065, në lidhje me masat parandaluese për të identifikuar dhe ulur rrezikun që mund të shkaktojë mospërputhshmëri në të ardhmen. Veprimet ndërmerren bazuar në analizë rreziku dhe përfshijnë masa që ulin mundësinë që rreziku të materializohet. Masat parandaluese dokumentohen dhe rishikohen në mënyrë periodike për të siguruar që ato efektivisht parandalojnë mospërputhshmëritë.

Neni 31

Procedurat e përditësimit të metodave të vlerësimit

1. Organizmi i certifikimit harton procedura për përditësimin e metodologjisë së vlerësimit që zbatohen kur ka ndryshime në kuadrin ligjor, situatën tërësore dhe në zbatimin e kostove të masave teknike, dhe organizative dhe rreziqe domethënëse. Përditësimi përfshin analizë të rrezikut dhe vlerësim mbi ndikimin e këtyre ndryshimeve në procesin e vlerësimit dhe efektivitetin të tij.

2. Organizmi i certifikimit harton procedura për të siguruar trajnim të personelit për të përditësuar kapacitetet/aftësitë, duke pasur parasysh ndryshimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

3. Organizmi i certifikimit harton procedura në rast reduktimi, pezullimi ose shfuqizimi të

akreditimit, duke përfshirë kriteret për këto raste dhe njoftimin e klientit. Njoftimi i klientëve kryhet brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh dhe klienti ka mundësinë e ankimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

KREU VII

MONITORIMI NGA KOMISIONERI

Neni 32

Monitorimi dhe mbikëqyrja e organizmave të certifikimit nga Komisioneri

1. Komisioneri monitoron dhe mbikëqyr nëse organizmat e certifikimit përmbushin kriteret e parashikuara në ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe këtë udhëzim, pavarësisht dhe pa cenuar kompetencat mbikëqyrëse që ushtron Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

2. Komisioneri, në kuadër të monitorimit dhe mbikëqyrjes, mund të kërkojë nga organizmi i certifikimit:

a) dokumente ose akte të ndryshme, duke përfshirë procedurat e brendshme që zbatohen prej tij në funksion të përmbushjes së kriterëve ligjore dhe atyre shtesë sipas këtij udhëzimi;

b) dokumentacionin ose informacionin e nevojshëm për të verifikuar përputhshmërinë me ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke vendosur afate për paraqitjen/depozitimin e tyre;

c) kryerjen e inspektimeve në terren, auditeve, si dhe vlerësimeve teknike të tjera të ngjashme. Për këtë qëllim, Komisioneri njofton organizmin e certifikimit të paktën 7 ditë përpara inspektimit, auditit ose vlerësimit.

3. Organizmi i certifikimit bashkëpunon me Komisionerin dhe vendos në dispozicion, në mënyrë të plotë dhe brenda afatit të caktuar, çdo informacion/dokument të kërkuar, si dhe kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për të lehtësuar monitorimin dhe mbikëqyrjen.

4. Komisioneri, me qëllim lehtësimin e monitorimit, vlerësimit të përputhshmërisë dhe të rrezikut që lidhet me certifikimin, kërkon nga organizmi i certifikimit raportim me shkrim mbi certifikimin e lëshuar sipas nenit 37, të ligjit nr.



124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke përfshirë objektin e certifikimit, numrin e tyre dhe periudhën e vlefshmërisë.

5. Në kuadër të bashkëpunimit institucional, Komisioneri mund të kërkojë nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit kopje të raportit të mbikëqyrjes mbi vlerësimin e konformitetit të hartuar në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe çdo informacion tjetër mbi organizmat e certifikimit të akredituar sipas këtij udhëzimi, objektin dhe statusin përkatës të akreditimit (vlefshmërinë, pezullimin ose shfuqizimin) ose të dhëna të tjera të nevojshme për zbatimin efektiv të kompetencave monitoruese dhe mbikëqyrëse sipas ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 33 Sanksionet

1. Në rast se Komisioneri konstaton mospërfutshmëri në ushtrimin e veprimtarisë nga organizmi i certifikimit në raport me ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ushtron sipas rastit kompetencat hetimore, korrigjuese ose sanksionuese të parashikuara në ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

2. Komisioneri, mund t’i propozojë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, shfuqizimin e akreditimit të organizmit të certifikimit, nëse konstaton se nuk janë plotësuar ose nuk plotësohen më kushtet dhe kriteret për akreditim ose nëse veprimet e organizmit të certifikimit shkelin ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 34 Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Organizmat e certifikimit që janë akredituar përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, sipas udhëzimit të Komisionerit nr. 48, datë 14.9.2018, “Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”, vazhdojnë të kryejnë veprimtarinë certifikuese deri në përfundim të afatit të akreditimit.

2. Udhëzimi nr. 47, datë 14.9.2018, “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të

dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” dhe udhëzimi nr. 48, datë 14.9.2018, “Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi

UDHËZIM Nr. 9, datë 20.11.2025

PËR KRITERET E PËRGJITHSHME PËR CERTIFIKIMIN DHE PËR DHËNIEN E VULAVE DHE TË SHENJAVE TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 37, të pikës 1, të nenit 85 dhe pikës 2, të nenit 97, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZON:

KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

1. Ky udhëzim parashikon kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale.

2. Procesi i përpunimit të të dhënave personale kontrollonhet dhe certifikohet nga organizmi i certifikimit vetëm nëse përmbush të gjitha parashikimet e mekanizmit të certifikimit të parashikuara në këtë udhëzim. Marrja e certifikimit, në përputhje me parashikimet e nenit 37 të ligjit dhe të këtij udhëzimi, konfirmon që procesi i përpunimit të të dhënave personale kryhet në përputhje me mekanizmin e certifikimit të miratuar nga Komisioneri.



Neni 2 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim si ato të parashikuara në ligj, si dhe ISO 27701 (siguria e të dhënave, siguria kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave personale – sistemet e menaxhimit të të dhënave personale – kritere dhe udhëzime). Termat e tjerë të përdorur në këtë udhëzim kanë këto kuptime:

a) “Certifikim” është procesi i zhvilluar nga organizmi i certifikimit, në përputhje me parashikimet e nenit 37 të ligjit, si dhe të këtij udhëzimi, me qëllim vlerësimin e konformitetit, në përfundim të të cilit klienti pajiset me vulën dhe shenjat për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të gjitha aspektet e tjera që përfshijnë garantimin e përputhshmërisë dhe vlefshmërisë së certifikimit;

b) “Vula dhe shenja” është simboli që do të përdoret nga organizmi i certifikimit për të treguar që një veprim përpunimi ose veprimet e përpunimit janë vlerësuar dhe janë gjetur në konformitet me kërkesat specifike ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale;

c) “Organizëm certifikimi” është personi juridik i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në përputhje me ligjin nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe udhëzimin e Komisionerit nr. 8, datë 20.11.2025, “Për kriteret shitesë për akreditimin e organizmit certifikues”;

ç) “Klient” është çdo person fizik apo juridik, publik ose privat, që bazuar në fushën e veprimtarisë ose në ushtrimin e kompetencave sipas ligjit, është kontrollues ose përpunues i të dhënave personale dhe për rrjedhojë i nënshtrohet vlerësimit të konformitetit dhe certifikimit me vula, dhe shenja sipas parashikimeve të ligjit dhe këtij udhëzimi;

d) “Audit” është procesi i kontrollit sistematik, i pavarur dhe i dokumentuar, nëpërmjet të cilit përftohen të dhëna audituese dhe vlerësuese që përcaktojnë në mënyrë objektive masën në të cilën janë përmbushur kriteret ligjore;

dh) “Komisioneri” është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

e) “Ligji” është ligji nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

KREU II MARRËDHËNIET MIDIS KLIENTIT DHE ORGANIZMIT TË CERTIFIKIMIT

Neni 3 Kërkesa për certifikim

1. Klienti paraqet pranë organizmit të certifikimit kërkesën me shkrim për certifikim të një ose disa veprim(eve) të përpunimit të të dhënave personale.

2. Klienti vendos në dispozicion të organizmit të certifikimit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për kryerjen e procedurës së certifikimit, si dhe mundëson akses në veprimtaritë e përpunimit.

Neni 4 Përdorimi i vulës dhe shenjave të mbrojtjes së të dhënave

1. Vulat dhe shenjat e mbrojtjes së të dhënave mund të përdoren vetëm nga ata kontrollues ose përpunues që kanë marrë certifikimin e duhur për proceset e përpunimit, në përputhje me parashikimet e këtij udhëzimi.

2. Klienti, që është certifikuar në përputhje me parashikimet e këtij udhëzimi, publikon në faqen zyrtare, në një vend të dukshëm, rezultatin e certifikimit, duke specifikuar veprimin apo veprimet e përpunimit përkatës.

Neni 5 Publikimi i listës së subjekteve të certifikuara dhe raportimi pranë Komisionerit

1. Organizmi i certifikimit publikon në faqen zyrtare të internetit, në një hapësirë të dedikuar, listën e të gjithë klientëve që ka kryer certifikim sipas këtij udhëzimi.

2. Brenda 31 dhjetorit të çdo viti kalendarik, organizmi i certifikimit dërgon informacion me shkrim pranë Komisionerit mbi klientët e certifikuar, duke specifikuar veprimin apo veprimet e përpunimit që janë certifikuar, si dhe problematikat e ndeshura në procesin e certifikimit.

3. Në rast se organizmi i certifikimit pezullon ose shfuqizon certifikimin, në përputhje me parashikimet e neneve 16 dhe 17 të këtij udhëzimi, ai përditëson listën e të gjitha subjekteve që ka kryer certifikim, të publikuar në faqen zyrtare të internetit.



Neni 6 Afati i certifikimit

Certifikimi që i lëshohet kontrolluesit ose përpunuesit është i vlefshëm për një periudhë jo më të gjatë se 3 (tre) vjet dhe mund të rinovohet sipas të njëjtave kritere të përcaktuara në këtë udhëzim.

KREU III KRITERET LIGJORE PËR CERTIFIKIMIN DHE DHËNIEN E VULAVE, DHE SHENJAVE

Neni 7 Kriteret e vlerësimit

1. Klienti që plotëson kriteret e mëposhtme, certifikohet sipas parashikimeve të këtij udhëzimi:

a) rezulton se ka Sistem të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) (ISO/IEC 27001), që është funksional dhe ushtron kontrolle specifike, lidhur me të dhënat personale;

b) rezulton se vepron bazuar në parimet e parashikuara në nenin 9 të këtij udhëzimi;

c) rezulton se zbaton ndarje të roleve dhe përgjegjësi të kontrolluesit, përpunuesit dhe nënpërpunuesve për të identifikuar, menaxhuar dhe raportuar cenime ose shkelje në të dhënat personale;

ç) rezulton se ekzistojnë procese të brendshme që tregojnë organizim në mënyrë të atillë që të mundësojnë ushtrimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave;

d) rezulton se ekzistojnë masa të sigurisë/mbrojtëse në rast se subjekti kryen transferim të të dhënave në shtete të treta ose organizata ndërkombëtare;

e) rezulton se ekzistojnë masa teknike dhe organizative që garantojnë nivel sigurie të përshtatshëm për rrezikun.

Neni 8 Sistemi i menaxhimit të të dhënave personale

1. Klienti ka detyrimin të krijojë, zbatojë, mirëmbajë dhe përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme një Sistem Menaxhimi të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System* “PIMS”) në përputhje me parashikimet e ISO/IEC 27701.

2. Klienti përcakton dhe gjurmon Treguesit Kyç të Performancës (*Key Performance Indicators* “KPI”) për të matur eficiencën e PIMS-së, kryen vlerësime nga niveli drejtues, të paktën një herë në vit, siguron përmirësim të vazhdueshëm, si dhe planifikon dhe kryen audit të brendshëm, të paktën një herë në vit për të vlerësuar përputhshmërinë dhe efektivitetin e PIMS-së.

Neni 9 Parimet mbi të cilat vepron klienti

1. Vlerësimi që kryen organizmi i certifikimit duhet të sigurojë që i gjithë përpunimi i të dhënave personale kryhet në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente. Baza ligjore për çdo veprim përpunues duhet të identifikohet, dokumentohet/evidentohet dhe është objekt rishikimi në intervale kohore të përcaktuara ose kur ndryshon veprimi(et) e përpunimit, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë së vazhdueshme dhe ekzistencës së nevojës.

2. Regjistrat (dosjet) e veprimit (eve) të përpunimit duhet të evidentojnë në mënyrë të qartë qëllimin e përpunimit dhe bazën ligjore ku është mbështetur ky përpunim.

3. Klienti duhet të respektojë parimet e mëposhtme:

a) parimin e ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës;

b) parimin e përpunimit në përputhje me qëllimin;

c) parimin e minimizimit të të dhënave;

ç) parimin e saktësisë së të dhënave;

d) parimin e kufizimit të ruajtjes në kohë;

e) parimin e integritetit dhe konfidencialitetit;

ë) parimin e përgjegjshmërisë.

4. Klienti kryen kontrolle të vazhdueshme për të monitoruar dhe verifikuar përputhshmërinë me këto parime. Klienti ka detyrimin të ruajë të dhëna që demonstrojnë përputhshmëri, duke përfshirë raportet e auditit, dosjet e verifikimit apo dokumente të tjera të ngjashme.

Neni 10 Ndarja e roleve dhe përgjegjësi të klientit

1. Roli dhe përgjegjësi të kontrolluesit, përpunuesit dhe nënpërpunuesve përcaktohen dhe dokumentohen në mënyrë të qartë.



2. Marrëveshja(et) për përpunimin e të dhënave personale përmbajnë dispozita mbi përgjegjësitë, rregullat që zbatohen midis palëve, si dhe përgjegjshmërinë. Vlerësimi përfshin kontrollin e hollësishëm (*due diligence*) dhe zbatimin e parashikimeve kontraktuale për nënpërpunuesit, si dhe ruajtjen e të dhënave (evidencave) për marrjen e masave që demonstrojnë përmbushjen e parimit të përgjegjshmërisë.

3. Vlerësimi përfshin verifikimin nëse ekzistojnë procedura të dokumentuara për të identifikuar, menaxhuar dhe njoftuar cenimet ose shkeljet në të dhënat personale. Procedurat që i përgjigjen situatave të cenimit ose shkeljes së të dhënave personale testohen në mënyrë periodike nëpërmjet simulimit për të siguruar efektivitetin e tyre.

4. Klienti kryen njoftimet për cenimin ose shkeljen e dhënave personale pranë Komisionerit, si dhe subjekteve të prekura në përputhje me nenin 29, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Njoftimi përmban informacion të plotë dhe të kuptueshëm, në lidhje me natyrën dhe masën e cenimit ose shkeljes, si dhe masat e ndërmarra për zbutjen e pasojave brenda kohës së kufizuar në dispozicion.

5. Klienti zbaton mbrojtjen e të dhënave në projektim (*privacy by design*) dhe në mënyrë të paracaktuar (*default*) si pjesë e sistemeve të integruara, shërbimeve dhe proceseve të tij. Masat teknike dhe organizative zbatohen me qëllim sigurimin që nëpërmjet mbrojtjes së të dhënave në mënyrë të paracaktuar (*default*), të përpunohen vetëm ato të dhëna personale që janë të nevojshme për qëllimin përkatës.

6. Klienti kryen vlerësime që përfshijnë konstatimin dhe dokumentimin e gjetjeve nga cenimi ose shkelja e të dhënave personale, me qëllim identifikimin e mundësive për përmirësim të vazhdueshëm. Mekanizimi përfshin një vlerësim të rregullt të politikave dhe proceseve të adresimit të cenimit ose shkeljes, me qëllim sigurimin që çdo incident të shërbejë si mundësi për të forcuar mekanizmat parandalues dhe masat reaguese. Procesi mbështetet nga angazhimi i nivelit drejtues të klientit për përmirësim të vazhdueshëm për masat e sigurisë dhe dokumentohet për të evidentuar zbatimin me efektivitet të tyre.

Neni 11

Ushtrimi i të drejtave nga ana e subjekteve të të dhënave

1. Klienti organizon proceset në mënyrë të atillë që të mundësojnë ushtrimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, duke përfshirë:

- a) të drejtën për informim;
- b) të drejtën për akses;
- c) të drejtën për korrigjim dhe fshirje;
- ç) të drejtën për t’u harruar;
- d) të drejtën për kufizimin e përpunimit;
- e) të drejtën për transferueshmërinë e të dhënave;
- ë) të drejtën për të kundërshtuar;
- f) të drejtën për të mos iu nënshtuar vendimeve automatike.

2. Subjektet e të dhënave gëzojnë të drejtën për përgjigje brenda afateve të parashikuara në ligj.

3. Klienti dokumenton dhe ruan të gjithë korrespondencën me subjektet e të dhënave. Sistemi i trajtimit të kërkesës përfshin verifikimin e identitetit të kërkuarit, regjistrimin e kërkesës, gjurmimin e ecursisë së trajtimit dhe rishikohet në mënyrë periodike për të verifikuar përmbushjen e detyrimeve ligjore brenda afatit.

Neni 12

Vlerësimi i rrezikut dhe vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave

1. Klienti kryen vlerësim të rregullt të rreziqeve që lidhen me veprimet e përpunimit të të dhënave personale.

2. Vlerësimi merr në konsideratë mundësinë, shkallën dhe ndikimin e mundshëm në të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave.

3. Vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave kryhet për veprimet e përpunimit që mund të shkaktojnë një rrezik të lartë të të drejtave dhe lirive themelore të individëve, në përputhje me nenin 31 të ligjit dhe rezultatet dokumentohen, vlerësohen dhe integrohen në proceset e menaxhimit të rrezikut. Vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave përditësohet në rast se rreziku mund të ketë ndryshuar si rezultat i faktorëve të jashtëm, si ndryshime në legjislacion, teknologji apo politika organizative. Ky proces kryhet në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.



4. Rezultatet e vlerësimit të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave dhe vendimet për trajtimin e rrezikut, miratohen nga struktura drejtuese përkatëse sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme të klientit dhe efektiviteti i tyre i nënshtrohet monitorimit të vazhdueshëm. Rivlerësimet e bazuara në ngjarje të caktuara kryhen sa herë që veprimet e përpunimit ndryshojnë apo ka përditësime rregullative.

Neni 13

Masat teknike dhe organizative

1. Klienti zbaton masat e nevojshme teknike dhe organizative që garantojnë nivel sigurie të përshtatshëm për rrezikun dhe përfshijnë:

a) pseudonimizimin dhe enkriptimin;

b) kontrollin e aksesit dhe menaxhimin e identitetit;

c) aftësitë e qëndrueshmërisë dhe për të rivendosur disponueshmërinë;

ç) testime të vazhdueshme dhe vlerësim të masave të sigurisë, duke përfshirë simulime të sulmeve dhe audite sigurie që janë të nevojshme për të garantuar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare dhe identifikuar vulnerabilitetet që mund të përbejnë rrezik për të dhënat;

d) testime të rregullta për depërtime dhe vlerësime vulnerabiliteti, duke përfshirë edhe masat korrigjuese.

2. Masat e përmendura në pikën 1 të këtij neni, rishikohen në mënyrë periodike për të siguruar efektivitet të vazhdueshëm. Klienti ndërmerr veprime të dokumentuara me karakter parandalues që përfshijnë monitorimin e vazhdueshëm dhe evidentimin e parregullsive.

3. Klienti ndërmerr masa të vazhdueshme për të rritur sigurinë e sistemeve, duke përfshirë analizimin e rezultateve të auditimit të sigurisë dhe testimeve, si dhe identifikimin e mundësive për përmirësim. Proces i përfshin bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm dhe të brendshëm, përdorimin e raporteve të detajuara për dobësitë e sistemit dhe sugjerime për përmirësim. Pjesë e procesit konsiderohet edhe vlerësimi dhe përditësimi i politikave të sigurisë për të ruajtur një nivel të lartë mbrojtjeje kundër rreziqeve të reja.

Neni 14

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave

1. Transferimi i të dhënave drejt vendeve të treta ose organizatave ndërkombëtare kryhet vetëm në rast se ekzistojnë masa mbrojtëse sipas parashikimeve në kreun IV të ligjit.

2. Vlerësimi përfshin dokumentimin dhe ruajtjen e provave të mekanizmit të transferimit, të tilla si vendimi i përshtatshmërisë, klauzolat standarde të mbrojtjes së të dhënave apo rregullat e detyrueshme të grupit të shoqërive tregtare. Përshtatshmëria e transferimit rishikohet në mënyrë periodike dhe lidhet me qëllimin specifik të përpunimit dhe bazën ligjore.

3. Vlerësimi evidenton qëllimin e transferimit të të dhënave dhe bazën ligjore përkatëse për këtë transferim. Informacioni pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe të aksesueshme për inspektime të jashtme dhe auditin, si dhe për të siguruar transparencë dhe përputhshmëri në mbrojtjen e të dhënave.

Neni 15

Administrimi i brendshëm i klientit

1. Struktura drejtuese e klientit që i nënshtrohet vlerësimit duhet të tregojë aftësi në drejtim dhe angazhim, në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System* “PIMS”), duke:

a) hartuar politika sigurie të harmonizuara me ISO/IEC 27701 dhe të përfshira në strategjitë e drejtimit të brendshëm dhe ato organizative;

b) përcaktuar role dhe përgjegjësi të qarta për mbrojtjen e të dhënave, duke përfshirë caktimin e një nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave, kur është e nevojshme;

c) integruar objektivat e mbrojtjes së të dhënave në të gjitha strategjitë organizative të veprimtarisë tregtare dhe kuadrit SMSI, duke përfshirë indikatorë kyç të performancës që i reflektojnë ato.

2. Klienti harton, dokumenton dhe mirëmban politika dhe procedura specifike për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Politikat përfshijnë përpunimin e të dhënave personale, ruajtjen, miratimin e organit(eve) drejtues(e) dhe transferimin ndërkombëtar dhe rishikohen e përditësohen në intervale kohore të përcaktuara. Verifikimet periodike nga niveli



drejtues sigurojnë që politikat të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme.

4. Klienti kryen trajnime për mbrojtjen e të dhënave dhe programe ndërgjegjësimi. Trajnimi organizohet bazuar në rolet dhe përgjegjësitë përkatëse, ka karakter të vazhdueshëm dhe dokumentohet si aftësim në menaxhimin e përgjegjësive që lidhen me të dhënat personale. Treguesit e efektivitetit janë të gjurmueshëm dhe përfshijnë përqindjet e stafit që ka kryer trajnimin, vlerësimin përkatës etj.

5. Klienti ruan informacion të dokumentuar mbi përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me parashikimet e nenit 27 të ligjit. Dokumentimi përfshin kategoritë e të dhënave, qëllimin, bazën ligjore, periudhën e ruajtjes, si dhe mekanizmat e transferimit.

6. Klienti zbaton procese të strukturuar për vlerësimin e rrezikut të mbrojtjes së të dhënave personale. Vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave kryhet për veprime përpunimi që shkaktojnë rrezik të lartë, në përputhje me ISO/IEC 27701, pika 7.2.5, dhe neni 31, i ligjit. Rezultatet e adresimit të rrezikut integrohen në Sistemin e Menaxhimit të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System* “PIMS”) dhe janë objekt i vlerësimit nga organi(et) drejtues(e).

7. Klienti planifikon dhe kryen audit të brendshëm të Sistemit të Menaxhimit të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System* “PIMS”) në përputhje me ISO/IEC 27701, pika 5.7.2, për të verifikuar përputhshmërinë me kushtet e mbrojtjes së të dhënave. Në rast se konstatohet mungesë përputhshmërie, klienti ndërmerr masa korrigjuese.

8. Klienti evidenton përmirësimin e vazhdueshëm të Sistemit të Menaxhimit të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System* “PIMS”) dhe siguron që ai të jetë efektiv, i përditësuar dhe në nivel të tillë që t'i përgjigjet ndryshimeve në veprimet e përpunimit apo kuadrit ligjor.

Neni 16

Pezullimi i certifikimit

1. Organizmi i certifikimit mund të pezullojë certifikimin e dhënë në përputhje me këtë udhëzim për një periudhë të caktuar kohe, në rast se:

a) monitorimi periodik ose rivlerësimi evidenton mospërputhje që nuk janë korrigjuar brenda afatit të përcaktuar;

b) klienti nuk i vendos në dispozicion organizmit të certifikimit informacionin, dokumentacionin ose qasjen e kërkuar në kuadër të veprimtarisë së monitorimit;

c) ndodhin ndryshime të rëndësishme në veprimet e përpunimit, në strukturën organizative ose në sistemin e menaxhimit që mund të ndikojnë në përputhshmëri dhe që nuk i janë njoftuar organizmit të certifikimit;

ç) ka hetime të përfunduara nga Komisioneri ose autoritete të tjera kompetente që mund të ndikojnë në përputhshmërinë me kriteret e certifikimit.

2. Gjatë periudhës së pezullimit, klienti nuk duhet të përdorë vulën ose shenjën e mbrojtjes së të dhënave, në lidhje me veprimin(et) e përpunimit që preken.

3. Organizmi i certifikimit dokumenton arsyet e pezullimit dhe njofton pa vonesë klientin dhe Komisionerin.

Neni 17

Shfuqizimi i certifikimit

1. Organizmi i certifikimit shfuqizon certifikimin, në rast se:

a) konstatohet që klienti nuk i plotëson më kriteret e certifikimit, duke përfshirë kërkesën për të mirëmbajtur funksionalitetin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) dhe Sistemit të Menaxhimit të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System* “PIMS”);

b) janë konfirmuar shkelje të rënda ose të përsëritura të ligjit;

c) klienti rezulton në keqpërdorim të vulës ose shenjës së mbrojtjes së të dhënave ose jep informacion të rremë apo mashtrues;

ç) procesi përpunues i certifikuar ka përfunduar, është ndryshuar ndjeshëm ose është zëvendësuar pa një rivlerësim paraprak.

2. Pas shfuqizimit, organizmi i certifikimit njofton menjëherë me shkrim Komisionerin, duke parashtruar arsyet dhe përditëson regjistrin publik të subjekteve të certifikuara.

3. Klienti ndërpret menjëherë përdorimin e çdo reference, vule ose shenje certifikimi dhe i heq ato nga komunikimet publike dhe faqen zyrtare të internetit.



Neni 18

Procesi i ricertifikimit

1. Klienti, certifikimi i të cilit është pezulluar ose shfuqizuar sipas këtij udhëzimi, mund të kërkojë përsëri certifikim, vetëm pasi të ketë vërtetuar se shkaqet e pezullimit ose shfuqizimit nuk ekzistojnë më ose janë korrigjuar.

2. Procesi i ricertifikimit ndjek të njëjtat procedura vlerësimi dhe verifikimi si certifikimi fillestar.

Neni 19

Transferimi i certifikimit

1. Në rast se klienti kërkon transferim të certifikimit, organizmi i certifikimit vepron në përputhje me skemën e certifikimit dhe sigurohet, që:

a) klienti të ketë një certifikatë të vlefshme në momentin e aplikimit;

b) organizmi i certifikimit merr një kopje të certifikatës ekzistuese, raportit të fundit të vlerësimit dhe dokumenteve mbi ankesat e paraqitura;

c) organizmi i certifikimit vlerëson mospërputhshmëritë që ekzistojnë, gjetjet e vlerësimit të fundit, ankesat dhe masat korrigjuese;

2. Organizmi i certifikimit merr vendim, në lidhje me transferimin e certifikimit brenda një muaji. Në rast se mungojnë dokumente ose ekzistojnë dyshime për përputhshmërinë e klientit, organizmi i certifikimit nuk e transferon atë dhe fillon procesin e certifikimit nga fillimi.

KREU IV

DISPOZITAT TRANZITORE DHE TË FUNDIT

Neni 20

Dispozita tranzitore

Certifikimet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, në përputhje me udhëzimin e Komisionerit nr. 48, datë 14.9.2018, “Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”, do të mbeten të vlefshme deri në përfundimin e tyre.

Neni 21

Dispozita përfundimtare

1. Të gjithë kontrolluesit/përpunuesit publik dhe privat në territorin e Republikës së Shqipërisë janë përgjegjës për respektimin dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Mosrespektimi i kërkesave të këtij udhëzimi përbën shkelje të ligjit dhe sanksionohet, sipas nenit 94, të tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi

VENDIM

Nr. 64, datë 23.10.2025

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 23.10.2025,
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 11 (R) 2024 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Renato Sina, përfaqësuar nga avokat Roland Islami, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokuror Alfred Progonati, me autorizim.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Genci Gjonçaj.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 110, datë 18.10.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr. 19, datë 4.3.2019, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 00–2024–1630, datë 3.10.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si



të papajtuësme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi si antikushtetues i nenit 224, të ligjit nr. 35/2017, datë 30.3.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, që ka ndryshuar nenin 403, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 7, 15, 17, 18, 32, 35, 36, 42, 49, 78, 116, 124, 125, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 138, 145, 147, 148, 149 dhe 179/“b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 49 dhe 50, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuësit Renato Sina (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) vetëm për kërkimin për shfuqizimin e nenit 224, të ligjit nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligji nr. 7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar” (*ligji nr. 35/2017*), që ka ndryshuar nenin 403, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), duke kërkuar rrëzimin e kërimit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Nga materialet e dosjes rezulton se midis kërkuësit dhe babait të tij, shtetasit P. S., nga njëra anë, si dhe vëllezërve T. S. dhe E. S., nga ana tjetër, në datën 8.2.2017 ka ndodhur një konflikt për të drejtat e përdorimit të materialeve të inerteve në lumin Drin, tek ura e fshatit Muhur në Dibër. Gjatë mosmarrëveshjes ka pasur shkëmbim zjarri me armë luftarake, nga të cilat është plagosur shtetasi E. S., i cili është dërguar menjëherë në Spitalin Rajonal

Dibër. Për shkak të plagëve të marra, shtetasi E. S. ka qenë në gjendje të rëndë shëndetësore dhe pas disa ditësh ka ndërruar jetë. Për këtë ngjarje, Policia Gjyqësore, në kushtet e flagrancës, ka proceduar me arrestimin e të dyshuarve, të kërkuësit dhe të shtetasve P. S. e T. S. Ndërkohë, nga hetimet paraprake të zhvilluara, ka rezultuar se shtetasi P. S. (babai i kërkuësit) është në lidhje gjinie të afërt (baballarët vëllezër) me shtetasit T. S. dhe E. S.

2. Në këto rrethana Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (*prokuroria*) ka regjistruar ndaj kërkuësit dhe shtetasve të tjerë P. S. dhe T. S. procedimin penal nr. 48 akti, datë 9.2.2017. Prokuroria i ka akuzuar ata për kryerjen e veprës penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, të kryer në bashkëpunim, të mbetur në tentativë (në këtë moment viktimë nuk kishte ndërruar ende jetë), sipas neneve 79/“c”, 25 dhe 22 të Kodit Penal (*KP*), për të cilën parashikohet dënimi jo më pak se 20 vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve të parashikuar nga neni 278, paragrafi i katërt, i KP-së.

3. Prokuroria, pas kryerjes së hetimeve, ka arritur në përfundimin se vetëm kërkuesi ka qenë autor i veprës penale të vrasjes së shtetasit E. S. dhe ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim, duke e akuzuar përfundimisht atë për kryerjen e veprës penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 79/“c” dhe 25 të KP-së, për cilësimin e së cilës ka administruar si prova certifikatat personale të kërkuësit, babait të tij dhe viktimës, si dhe për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”. Ndërsa dy shtetasit e tjerë P. S. dhe T. S. janë akuzuar për veprën penale “Dhuna në familje”, të parashikuar nga neni 130/“a”, paragrafi i parë, i KP-së.

4. Në datën 11.7.2017, sipas kërkesës së prokurorisë, çështja penale i ka kaluar për gjykim Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (*gjykata e shkallës së parë*), e cila ka caktuar datën 27.7.2017, për zhvillimin e seancës gjyqësore. Ndërkohë, me shkresat e datës 26.7.2017, mbrojtësi i kërkuësit i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë, duke parashtruar tri kërkesa për: i. shpalljen e moskompetencës lëndore të saj; ii. ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, si të kryer në



kushtet e mbrojtjes së nevojshme; iii. zhvillimin e procesit me procedurën e gjyqimit të shkurtuar.

5. Në vijim, seanca gjyqësore e datës 27.7.2017, është shtyrë pas kërkesës së paraqitur nga mbrojtësi i të bashkëpandehurit T. S. Për këtë arsye, gjyqtari relator, mes të tjerave, me shkresën e datës 27.7.2017, ka njoftuar kërkuesin për zhvillimin e seancës gjyqësore në datën 14.9.2017, e cila është shtyrë për t'u zhvilluar në datën 28.9.2017, për shkak se nuk provohej fakti që i bashkëpandehuri T. S. kishte marrë dijeni të rregullt për datën dhe orën e seancës. Edhe seanca e datës 28.9.2017, është shtyrë për shkak të mosekzekutimit korrekt të urdhrit të shoqërimit për të bashkëpandehurin T. S. Seanca e radhës u caktua për t'u zhvilluar në datën 12.10.2017.

6. Gjatë seancës së datës 12.10.2017 gjykata e shkallës së parë ka marrë në shqyrtim kërkesat e paraqitura nga mbrojtësi i kërkuesit dhe ka vendosur: i. se është kompetente për gjykimin e veprës penale për të cilën akuzohet kërkuesi, të parashikuar në nenin 79/“c” të KP-së; ii. rrëzimin e kërimit për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, duke arsyetuar se cilësimi juridik i veprës penale, nëse është i saktë ose jo, si dhe çështje të tjera objekt gjykimi që lidhen me fajësinë ose pafajësinë dhe masën e dënimit nuk mund të shqyrtohen ose disponohen nga gjykata në këtë moment procedural, pasi në fazën e kërkesave paraprake gjykata nuk ka marrë në shqyrtim asnjë provë të paraqitur nga prokurori ose palët në funksion të këtij gjykimi. Nga përmbajtja e procesverbalit të kësaj seance gjyqësore nuk rezulton që gjykata e shkallës së parë të jetë shprehur për kërkesën për gjykimin e shkurtuar, për shkak se nga prokuroria është paraqitur një provë e re dhe me qëllim lënien kohë mbrojtësit të kërkuesit për t'u njohur me të, seanca gjyqësore është shtyrë për në datën 26.10.2017. Kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues dhe është caktuar data 2.11.2017 për zhvillimin e seancës së ardhshme gjyqësore.

7. Në seancën e datës 2.11.2017, pasi ka dëgjuar palët, gjykata e shkallës së parë ka vendosur refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, duke arsyetuar se tashmë (në datën 1.8.2017) kishte hyrë në fuqi ligji nr. 35/2017, me të cilin ishte ndryshuar edhe pika 2, e nenit 403 të KPP-së, duke parashikuar se “*nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për vepra penale për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm*”, për pasojë duke qenë se për veprën

penale të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare parashikohej dënimi jo me pak se 20 vjet burgim ose burgim të përjetshëm, çështja do t'i nënshtrohej procedurës së gjyqimit të zakonshëm (*shih faqen 9, të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda*).

8. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë, me vendimin nr. 110, datë 18.10.2018, mes të tjerave, ka vendosur deklarinin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprave penale: i. “Vrasja me dashje” dhe në bazë të nenit 76 të KP-së, dënimin me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim; ii. “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 1, i KP-së dhe dënimin me 4 (katër) vjet burgim. Në zbatim të nenit 55 të KP-së, pas bashkimit të dënimeve, është vendosur dënimi me 20 (njëzet) vjet burgim.

9. Ndaj vendimit ka paraqitur ankim Prokuroria, duke kërkuar ndryshimin e vendimit vetëm në lidhje me cilësimin e veprës penale për të pandehurin Renato Sina/kërkuesin, duke e deklaruar fajtor për veprat penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, të parashikuar nga neni 79/“c” i KP-së dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 1, i KP-së, si dhe në bashkim të dënimeve, dënimin me 35 vjet burgim. Ankim ka paraqitur edhe kërkuesi, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë për cilësimin juridik të veprës penale, duke pretenduar se duhej të cilësohej si plagosje e rëndë, me pasojë vdekjen, e kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, e parashikuar si vepër penale nga neni 88, pika 2 dhe 19, të KP-së. Për veprën penale të armëmbajtjes pa leje kërkuesi ka kërkuar dënimin me kohën e paraburgimit.

10. Gjkata e Apelit për Krime të Rënda (*gjykata e apelit*), me vendimin nr. 19, datë 4.3.2019, ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga prokuroria për shkak të heqjes dorë prej tij dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 110, datë 18.10.2018, të gjykatës së shkallës së parë për pjesën e deklarinimit fajtor të kërkuesit për kualifikimin ligjor të veprës penale “Vrasja me dashje”, sipas nenit 76 të KP-së. Gjkata e apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit vetëm në lidhje me disponimin për masën e dënimit për këtë vepër penale, duke e dënuar kërkuesin me 15 vjet burgim, sipas neneve 76 dhe 48, shkronja “ç” dhe 49 të KP-së. Gjkata e apelit ka vendosur lënien



në fuqi të vendimit për kërkuesin në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i KP-së. Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 të KP-së, ka vendosur dënimin me 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim. Ndaj vendimit, mes të tjerëve, ka ushtruar rekurs edhe kërkuesi, për të cilin Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1630, datë 3.10.2024, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

11. Kërkuesi në datën 19.12.2024, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 12.2.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se:

12.1 Gjatë procesit gjyqësor është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

12.1.1 *Së drejtës për gjykim të shkurtuar dhe së drejtës për të përfituar uljen me një të tretën e dënimit për shkak të shkeljeve të rënda procedurale*, pasi prokuroria ka gabuar në cilësimin juridik të akuzës në lidhje me faktet, duke rënduar pozitën e kërkuesit. Prokuroria e ka kualifikuar veprën penale për shkak të marrëdhënieve familjare, duke arsyetuar se viktima ishte gjini e afërt me kërkuesin, por në fashikull nuk gjendet asnjë provë për të provuar këtë marrëdhënie. Në kuptim të nenit 16 të KPP-së kërkuesi dhe viktima nuk janë “gjini e afërt”. Nga certifikatat familjare rezulton se ata janë kushërinj të brezit të gjashtë. Kërkuesi e ka kryer veprën penale në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, pasi viktima kishte qëlluar në drejtim të tij me armë “automatik”, prandaj vepra duhet të ishte kualifikuar si plagosje e rëndë me pasojë vdekjen, e kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme. Në mënyrë që vepra penale të kualifikohet sipas nenit 79/“c” duhet që viktima dhe autori të kenë marrëdhënie të posaçme sipas përcaktimeve ligjore. Cilësimi juridik i gabuar i akuzës ka sjellë zbatimin e gabuar të nenit 403 të KPP-së, të ndryshuar. Gjithashtu, ky nen nuk gjen zbatim për rastin konkret, sepse ngjarja ka ndodhur përpara ndryshimeve të KPP-së dhe ligji penal nuk ka fuqi prapavepruese nëse nuk është favorizues për

të pandehurin. Për të gjitha këto arsye kërkuesit i është cenuar e drejta për të përfituar nga gjykimi i shkurtuar.

12.1.2 *Standardit të arsyetimit të vendimit për kërkesën për cilësimin e veprës penale në kushtet e mbrojtjes së nevojshme*, sepse gjykatat nuk kanë arsyetuar për kërkesën e kualifikimit të veprës penale si të kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, pasi çdo veprim i kërkuesit ka pasur si qëllim kundërpërgjigjen e sulmit ndaj tij. Kërkuesi ka qëlluar ndaj viktimës, por ka qenë kjo e fundit që ka qëlluar e para. Kërkuesi, megjithëse ka pasur mundësi për të vazhduar sulmin, me vullnetin e tij e ka ndërprerë atë. Në rastin konkret, edhe nëse do të ishim në kapërcim të kushteve të mbrojtjes së nevojshme, ligjvënësi në nenin 88/“b” të KP-së ka parashikuar veprën penale të plagosjes së rëndë në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme. Gjatë gjykimit është kërkuar që vepra penale të kualifikohet në kuadër të mbrojtjes së nevojshme sipas nenit 19 të KP-së dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë arsyetuar për këtë kërkesë, duke cenuar në këtë mënyrë edhe parimin e barazisë mes palëve.

12.1.3 *Parimit të mosgjykimit pa ligj*, pasi gjykata u ka dhënë fuqi prapavepruese ndryshimeve të nenit 403, pika 2, të KPP-së, në shkelje edhe të vendimit nr. 4, datë 27.3.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke cenuar disa parime, si: fuqia prapavepruese e ligjit, *ex post facto* dhe *in mitius, lex retro agit in mitius*. Duke qenë se gjykimi kishte filluar përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve të vitit 2017 të KPP-së, gjykatat nuk mund të rrëzonin kërkesën për gjykim të shkurtuar vetëm me pretendimin se në kohën e shqyrtimit të kërkesës kishte ndryshuar neni 403, pika 2, i KPP-së. Në rastin konkret ligji nuk është favorizues për kërkuesin dhe cenon edhe të drejtën për gjykim të shkurtuar. Kërkuesit i është cenuar e drejta për gjykim të shkurtuar vetëm si rezultat i akuzës së gabuar të prokurorisë, që është pranuar edhe nga prokuroria e apelit, pasi ka hequr dorë nga ankimi, në kushtet kur gjykata kishte vendosur ndryshimin e cilësimit juridik të akuzës. Në nenin 3 të KP-së parashikohet se kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale.

12.1.4 *Parimit të barazisë përpara ligjit e të mosdiskriminimit dhe parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë marrë



vendime në kundërshtim me praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë, konkretisht me vendimin nr. 308, datë 20.11.2013, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në lidhje me elementin volitiv të të pandehurit dhe mundësinë e ardhjes së pasojës për të bërë dallimin midis vrasjes me dashje të mbetur në tentativë dhe plagosjes së rëndë me dashje, duke cenuar edhe parimin e sigurisë juridike. E drejta për t'u trajtuar i barabartë është cenuar nga gjykatat më të ulëta, që nuk kanë arsyetuar për llojin e sulmit që i ka ndodhur kërkuesit dhe babait të tij, si dhe kundërpërgjigjen që ka bërë ai ndaj këtij sulmi të padrejtë. Gjykata duhet ta trajtojë cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit e të mosdiskriminimit për dy shkaqe: i. arsyetimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, sipas të cilit nuk merret në shqyrtim cilësimi juridik i akuzës kur provueshmëria juridike e akuzës në rastin konkret nuk kërkon hetim; ii. Gjykata e Lartë, në një rast tjetër, në të njëjtat rrethana ligjore, ka mbajtur qëndrim të ndryshëm lidhur me pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar. Gjithashtu, nisur nga fakti se gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje këtij pretendimi, Gjykata duhet ta trajtojë atë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, gjykimin pa ligj dhe të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ligjor për shkak të sjelljes të të bashkëpandehurit T. S., që ka pasur edhe cilësinë e të dëmtuarit nga vepra penale.

12.2 *Gjykatat kanë zbatuar gabim nenin 152 të KPP-së (çmuarja e provave)*, pasi kanë keqzbatuar këtë dispozitë lidhur me çmuarjen e provave, si dhe nuk kanë arsyetuar për kërkesën e paraqitur nga mbrojtja e kërkuesit për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, duke e rikualifikuar në kuadër të mbrojtjes së nevojshme. Gjykatat duhet të arsyetonin vendimin duke mbajtur në konsideratë se kërkuesi nuk ka pasur si qëllim privimin e sulmuesit nga jeta, por vetëm për të zmbrazur sulmin e atëçastshëm, të rrezikshëm dhe të kundërligjshëm që i ishte drejtuar atij. Në rastin konkret, duke u nisur nga domosdoshmëria që kishte kërkuesi për të qëlluar mbi viktimën si rezultat i goditjes në mënyrë të vazhdueshme me automatik nga ai, intensiteti i goditjeve me pistoletë dhe zonat ku janë përqendruar dëmtimet tek trupi i viktimës janë të tilla që duhet të orientonin gjykatat drejt ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale.

12.3 *Neni 224, i ligjit nr. 35/2017, që ka ndryshuar nenin 403, pika 2, të KPP-së (neni 403, pika 2, i KPP-së, i ndryshuar)*, cenon:

12.3.1 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, pasi i heq mundësinë të pandehurit t'i kërkojë gjykatës zbatimin e kriterëve ligjore të procedurës të gjykimit të shkurtuar. Dispozita bie ndesh edhe me nenin 145, pika 1, të Kushtetutës, pasi ky rregullim ka penguar gjykatat në dhënien e drejtësisë, duke cenuar pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

12.3.2 *Parimin e prezumimit të pafajësisë*, sepse gjykimi i veprave penale, për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm, fillon duke e paragjykuar cilësimin juridik të veprës penale pa kryer hetim e gjykim për kërkesën e prokurorit, por duke e marrë atë të mirëqenë e duke rënduar pozitat e të pandehurit në gjykim. Kërkuesi është deklaruar fajtor jo për veprën penale për të cilën akuzohej, por për atë të vrasjes me dashje, për të cilën ai do të kishte përfutur nga gjykimi i shkurtuar. Për shkak të mënyrës së zbatimit të tij, rezulton se gjykatat janë përqendruar vetëm në akuzën e paraqitur nga prokuroria.

12.3.3 *Parimin e sigurisë juridike*, pasi nuk respekton kriteret e qartësisë dhe saktësisë, si dhe ndryshon raportin mes shtetit dhe shtetasit që ndiqet penalisht. Në rastin konkret, kërkuesit i është bërë kualifikim ligjor i veprës penale i gabuar, duke iu cenuar e drejta për gjykim të shkurtuar. Në këto kushte, kërkuesi ka qenë në pozita të pabarabarta me organin e akuzës në gjykim.

12.3.4 *Parimin e barazisë përpara ligjit*, pasi parashikon heqjen e së drejtës për gjykim të shkurtuar për shkak të llojit të dënimit, duke krijuar situata diskriminuese, pa përligje të arsyeshme e objektive. Heqja e së drejtës për gjykim të shkurtuar për kërkuesin nuk justifikohet me ndonjë interes publik, si dhe gjykatat nuk kanë dhënë argumente të mjaftueshme.

13. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, ka prapësuar për sa vijon:

13.1 *Për të drejtën për proces të rregullt ligjor*:

13.1.1 *Pretendimi për moszbatimin e gjykimit të shkurtuar* është i pabazuar, pasi gjykatat kanë vendosur rrëzimin e kërkesës duke u bazuar në nenin 403, pika 2, të KPP-së. Pretendimi i kërkuesit është në kundërshtim me kriteret dhe kushtet e përcaktuara nga KPP-ja për gjykimin e shkurtuar, vendimin unifikues nr. 2, datë 29.1.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe



vendimin nr. 4, datë 10.2.2012, të Gjykatës. Riti i gjykimit të shkurtuar nuk lidhet me disponimin përfundimtar të gjykatës për veprën penale që do të dënohet i pandehuri, por me procedimin penal të dërguar për gjykim nga prokuroria, me veprën penale për të cilën ka filluar shqyrtimi gjyqësor. Në kushtet kur kërkuesi ka qenë i akuzuar për një vepër penale për të cilën KPP-ja ndalon aplikimin e gjykimit të shkurtuar, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se nuk kanë qenë kushtet ligjore për të proceduar me gjykimin e shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, ajo gjykatë ka vlerësuar ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale. Gjithashtu, gjykimi i shkurtuar mund të aplikohet kur gjykata vlerëson dhe bindet se mund ta zgjidhë çështjen në gjendjen që janë aktet, pa qenë nevoja për shqyrtim gjyqësor. Ndërsa në rastin konkret, për shkak të zhvillimit të gjykimit sipas procedurës së zakonshme, kërkuesi ka dorëzuar prova dhe ka kërkuar marrjen e provave të reja, që kanë bërë të mundur ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit penal dhe dënimit të tij me një masë më të ulët se dënimi me burgim të përjetshëm. Në këtë këndvështrim nuk kanë ekzistuar kushtet që të mund të procedohej me gjykimin e shkurtuar.

13.1.2 *Pretendimet për ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale nga gjykata dhe mosaplikimi i nenit 403, pika 2, të KPP-së* kanë të bëjnë me themelin e çështjes që kanë gjykuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Ato janë të lidhura me vlerësimin e provave dhe mënyrën e interpretimit e zbatimit të së drejtës materiale e procedurale (mënyra e kualifikimit të veprës penale, kuptimi i veprës penale dhe vlerësimi i provave) dhe nuk është detyrë e Gjykatës të analizojë provat dhe faktet ku janë bazuar gjykatat për zgjidhjen e themelit të çështjes. Nga aktet e dosjes rezulton se nuk janë konstatuar shkelje që do ta bënin procesin të parregullt nga ana ligjore. Vendimet e gjykatave janë rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit material dhe procedural për sa i përket vlerësimit të provave, cilësimit ligjor, llojit të dënimit dhe trajtimit të kërkesës për gjykimin e shkurtuar. Për pasojë, nuk konstatohet që gjatë procesit gjyqësor të ketë pasur shkelje të të drejtave kushtetuese ose zbatim arbitrar të ligjit, në kuptimin që të jetë haptazi në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës. Kualifikimi ligjor i veprës penale është atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, të cilat shqyrtojnë dhe vlerësojnë provat.

13.1.3 *Pretendimi për gjykimin pa ligj* nuk është i bazuar. Mosaplikimi i gjykimit të shkurtuar dhe për pasojë edhe mospërfitimi që sjell ky lloj gjykimi, duke përfituar uljen me një të tretën e dënimit, nuk kanë ardhur vetëm për shkak se nga gjykata u është dhënë fuqi prapavepruese ndryshimeve të bëra në nenin 403 të KPP-së, të ndryshuar në vitin 2017, por sepse çështja nuk mund të gjykohej në gjendjen që ishin aktet. Edhe gjykata e apelit ka arsyetuar se zhvillimi i gjykimit të zakonshëm nën parimin e kontradiktoritetit ka bërë të mundur ndryshimin e cilësimit ligjor dhe lehtësimin e pozitës juridike të kërkuesit.

13.2 *Pretendimi për shfuqizimin e nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar*, pasi cenon parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin e sigurisë juridike, nuk gjen mbështetje kushtetuese e ligjore. Kuvendi, si organ ligjvënës, ka të drejtë të përcaktojë marrëdhëniet që rregullohen me nxjerrjen e një ligji të caktuar dhe njëkohësisht të përjashtojë nga përfitimi që parashikon ai ligj. Në këtë aspekt është në kompetencë të Kuvendit që për efekt të luftës kundër kriminalitetit dhe dhënies së drejtësisë efektive të përjashtojë një kategori veprash penale nga përfitimet që sjell gjykimi i shkurtuar. Mundësia e të pandehurit për t'i kërkuar gjykatës zbatimin e kritereve ligjore të procedurës së gjykimit të shkurtuar është një e drejtë e tij, por është atribut i gjykatës për të vendosur nëse plotësohen kriteret ligjore për pranimin e gjykimit të shkurtuar, për rrjedhojë uljen e dënimit me një të tretën.

14. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, ka paraqitur parashtrime me shkrim vetëm për kërkimin për shfuqizimin e nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar, si vijon:

14.1 *E drejta për një gjykim të drejtë* garantohet përmes procedurës së rregullt gjyqësore dhe jo nëpërmjet një forme specifike sikurse është gjykimi i shkurtuar. Ky i fundit është një alternativë procedurale e bazuar në rrethana të caktuara dhe jo një e drejtë kushtetuese për çdo të pandehur. Ligjvënësi ka të drejtë të kufizojë aplikimin e saj për raste që nga natyra kërkojnë një analizë më të thelluar të provave dhe fakteve. Edhe pretendimi i kërkuesit se nuk ka përfituar uljen e dënimit për shkak të ndalimit të gjykimit të shkurtuar, nuk përbën shkelje të procesit të rregullt ligjor, pasi gjykimi i shkurtuar është një përfitim që lidhet ngushtësisht me përdorimin e një procedure të veçantë dhe jo një e drejtë e garantuar për të gjithë



personat e proceduar penalisht. Nëse procedura nuk zbatohet, përfitimet e saj nuk mund të pretendohen. Zbatimi i nenit 406 të KPP-së është i kushtëzuar nga vetë lejueshmëria e gjykimit të shkurtuar. Nuk ka detyrim kushtetues për të garantuar uljen e dënimit në çdo rrethanë dhe dënimi i vendosur sipas procesit të rregullt ligjor nuk përbën cenim të të drejtave kushtetuese.

14.2 *Për parimin e sigurisë juridike*, neni 403, pika 2, i KPP-së të ndryshuar është një dispozitë që ka dëshmuar stabilitet juridik ndër vite në raport me vetë normat e këtij kodi, i cili u është nënshtruar ndryshimeve ligjore ndër vite. Neni 403, pika 2, i KPP-së është një normë e qartë, e kuptueshme dhe e parashikueshme. Ai përjashton në mënyrë të drejtpërdrejtë aplikimin e gjykimit të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm. Nuk ka asnjë paqartësi ligjore në formulim dhe çdo subjekt i ligjit e kupton saktësisht kufirin e zbatueshmërisë së dispozitës.

14.3 *Dispozita nuk cenon garancitë e nenit 17 të Kushtetutës*. Nga leximi i dispozitës objekt kundërshtimi dhe jurisprudencës kushtetuese kuptohet se qëllimi i ligjvënësit nuk ka qenë cenimi i të drejtave të pandehurit, por garantimi i një procedure të plotë gjyqësore për veprat penale më të rënda, duke pasur parasysh se burgimi i përjetshëm është forma më ekstreme e sanksionit penal.

14.4 *Pretendimi se dispozita cenon nenin 18 të Kushtetutës, i cili rregullon parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit nuk qëndron*, pasi ky parim nuk nënkupton trajtim të njëjtë për të gjithë, por kërkon trajtim të barabartë në raste të ngjashme. Personat që akuzohen për vepra për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm nuk janë në të njëjtën situatë juridike me ata që akuzohen për vepra për të cilat parashikohen dënime më të lehta.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

15. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave

kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/“a”, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

16. Në rastin konkret Gjykata konstaton se kërkuari në ankimin kushtetues individual ka parashtruar 2 kërtime: 1. për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të dhëna në procesin gjyqësor penal të zhvilluar ndaj tij; 2. për shfuqizimin e nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar. Në këtë këndvështrim, kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, sepse është palë në procesin gjyqësor penal objekt kundërshtimi, gjatë të cilit është zbatuar edhe neni 403, pika 2, i KPP-së, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se kërkuari ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

17. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individit pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Rregulli i shterimit të mjeteve juridike nënkupton jo vetëm që kërkuari t’u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme, përpara se t’i drejtohet Gjykatës, por edhe që të gjitha pretendimet (shkaqet) që ngre në këtë Gjykatë, t’i ketë paraqitur më parë në të gjitha instancat e zakonshme gjyqësore, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Ndërsa në lidhje me ankimin kushtetues individual, me objekt kundërshtimin si antikushtetues të ligjit ose aktit normativ, Gjykata ka theksuar se kërkuari duhet t’i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese që cenon ligji i kundërshtuar jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve



publike ose vendimeve gjyqësore, prandaj individ duhet, së pari, t'i kundërshtojë ato përpara gjykatave kompetente, duke shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon sistemi ynë juridik. Kjo ka rëndësi edhe për të provuar se kërkuksi është prekur personalisht, drejtpërdrejt dhe realisht. Gjithsesi, meqenëse mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimin nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata vlerëson se kërkuksi e plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor penal në të tria shkallët e gjyqësorit, duke parashtruar pretendimet e tij përpara tyre si në formë dhe në substancë. Gjithashtu, ai përmbush kriterin e shterimit të mjeteve juridike edhe për pretendimet për kundërshtimin e nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar, duke qenë se, sikundër u theksua më sipër, kjo dispozitë është zbatuar gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar, prandaj kërkuksi nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

20. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, kërkuksi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 19.12.2024, ndërsa vendimi gjyqësor më i fundit që kundërshtohet është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 3.10.2024. Për rrjedhojë, ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga nenet 50, pika 4, për kundërshtimin e normës juridike, si dhe 71/“a”, pika 1, shkronja “b”, për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore, të ligjit nr. 8577/2000.

21. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuksi ka pretenduar në lidhje me vendimet gjyqësore të kundërshtuara cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtëm të së drejtës për gjykim të shkurtuar dhe së drejtës për të përfutur uljen me një të tretën e dënimit për shkak të shkeljeve të rënda procedurale, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor për kërkesën për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, parimit të mosgjykimit pa ligj, parimit të barazisë përpara ligjit e të mosdiskriminimit dhe parimit të sigurisë juridike, si dhe zbatimit të gabuar të nenit 152 të KPP-së.

22. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit kërkuksi ka parashtruar dy shkaqe: i. arsytimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk analizon cilësimin juridik të akuzës edhe pse provueshmëria juridike e akuzës nuk kërkon hetim; ii. Gjykata e Lartë në një rast tjetër, në të njëjtat rrethana ligjore, ka mbajtur qëndrim të ndryshëm lidhur me pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, duke vendosur lënien në fuqi të gjykimit të shkurtuar. Për *shkakun e dytë*, sipas kërkuksit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 308, datë 20.11.2013, ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga rasti i tij. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të mbështesë *apriori* pretendimin për shkeljen e parimit të barazisë përpara ligjit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 17, datë 23.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm në rastet e ekzistencës së vendimeve njësuere/unifikuese, gjykatat, duke mos analizuar çështjen konform këtyre vendimeve, cenojnë parimin e sigurisë juridike të kërkuksit për zbatimin e ligjit në harmoni me praktikën gjyqësore të kësaj gjykate (*shih vendimin nr. 47, datë 11.6.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj, në kushtet kur kërkuksi nuk argumenton nëse vendimi i referuar prej tij është njësuere/unifikues i praktikës gjyqësore, pra që të jetë i detyrueshëm për zbatim nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, pretendimi i kërkuksit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit është haptazi i pabazuar.

23. Ndërsa për pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtëm të: i. së drejtës për gjykim të shkurtuar dhe së drejtës për të përfutur uljen me një të tretën e dënimit për shkak të shkeljeve të rënda procedurale; ii. parimit të mosgjykimit pa ligj, pasi gjykatat e zakonshme i kanë dhënë fuqi prapavepruese ndryshimeve të nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar; iii. zbatimit të gabuar të nenit 152 të KPP-së, Gjykata vëren se thelbi i argumenteve të paraqitura nga kërkuksi lidhet me mospërfutimin e uljes së një të tretës së dënimit, sipas parashikimeve ligjore që sipas tij duhet



të ishin zbatuar, për shkak të cilësimit të gabuar të veprës penale nga ana e prokurorisë, prandaj Gjykata do t'i analizojë ato në drejtim të parimit të mosdënimit pa ligj. Gjithashtu, për sa i takon shkakut të parë të pretendimit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit (shih paragrafin 22 të vendimit), nisur nga thelbi i argumenteve të parashtruara nga kërkuesi, ai do të analizohet së bashku me pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, pretendimet në lidhje me vendimet gjyqësore Gjykata do t'i analizojë në këndvështrim të parimit të mosdënimit pa ligj dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

24. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae* në lidhje me kërkimin për shfuqizimin e nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar, kërkuesi ka pretenduar se dispozita bie ndesh me të drejtën për proces të rregullt ligjor, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e sigurisë juridike dhe atë të barazisë përpara ligjit. Gjykata vëren se thelbi i parashtrimeve të kërkuesit, edhe në lidhje me këtë dispozitë ka të bëjë ngushtësisht me zbatimin e saj në procesin gjyqësor penal të zhvilluar ndaj kërkuesit, prandaj ajo do t'i analizojë pretendimet për nenin 403, pika 2 të KPP-së, të ndryshuar, të lidhura me të drejtën për proces të rregullt ligjor, pra me pretendimet për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj

25. Kërkuesi ka pretenduar se për shkak të shkeljeve të rënda procedurale dhe cenimit të të drejtave gjatë procesit gjyqësor penal ai nuk ka përfituar uljen me një të tretën e dënimit. Sipas tij, për shkak se prokuroria ka gabuar në cilësimin juridik të akuzës, në lidhje me faktet e ngjarjes penale, është rënduar pozita juridike e kërkuesit. Prokuroria nuk ka sjellë asnjë argument për cilësimin juridik të veprës penale për shkak të gjinisë së afërt, madje nuk ka shpjeguar në pretendimet përfundimtare marrëdhënien farefisnore mes kërkuesit dhe viktimës. Për shkak të cilësimit juridik të gabuar të akuzës, gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar kërkesën e kërkuesit për të zhvilluar procesin sipas gjykimit të shkurtuar.

26. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se gjykatat kanë vendosur rrëzimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar duke u bazuar në nenin 403, pika 2, të KPP-së, pas ndryshimeve të vitit 2017. Pretendimi i kërkuesit është në kundërshtim me kriteret dhe

kushtet e përcaktuara nga KPP-ja për gjykimin e shkurtuar, vendimin unifikues nr. 2, datë 29.1.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe vendimin nr. 4, datë 10.2.2012, të Gjykatës. Në kundërshtim nga sa pretendon kërkuesi, riti i gjykimit të shkurtuar nuk lidhet me disponimin përfundimtar të gjykatës se për cilën vepër penale do të dënohet i pandehuri, por me procedimin penal të dërguar për gjykim, me atë se për cilën vepër penale vendoset dërgimi i çështjes për gjykim. Në kushtet kur kërkuesi ka qenë i akuzuar për një vepër penale për të cilën KPP-ja ndalon aplikimin e gjykimit të shkurtuar, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se nuk kanë qenë kushtet ligjore për të proceduar me gjykimin e shkurtuar.

27. Gjykata ka theksuar se e drejta për të mos u dënuar pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*), e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar të individit (shih vendimet nr. 32, datë 30.5.2023; nr. 16, datë 15.6.2009; nr. 14, datë 17.4.2007, të Gjykatës Kushtetuese).

28. Ndërsa në lidhje me karakteristikat e gjykimit të shkurtuar, i cili hyn në kategorinë e gjykimeve të posaçme, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kur i pandehuri ka bërë kërkesë që të procedohet me këtë lloj gjykimi, nëse gjykata e zakonshme çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, pa iu nënshtuar provat debatit gjyqësor dhe pa marrë prova të reja, vlerësim i cili konsiston në bindjen e brendshme të gjyqtarit, vendos gjykimin e shkurtuar. Pra, gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit, i cili nëse ka dyshime për këtë vlerësim, mund të rrëzojë kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme, duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor (shih vendimet nr. 6, datë 26.2.2013; nr. 14, datë 26.3.2012; nr. 4, datë 10.2.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

29. Për sa i përket kërkesës për gjykim të shkurtuar, Gjykata konstaton se neni 403 i KPP-së, përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 35/2017, parashikonte se i pandehuri/përfaqësuesi i tij mund të kërkojë që çështja të përfundohet në gjendjen që janë aktet derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor. Sipas parashikimit të kësaj dispozite,



kërkesa për të zgjidhur çështjen në gjendjen që janë aktet nuk kufizohet nga lloji i veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri. Me ligjin nr. 35/2017, neni 403, pika 2, i KPP-së ndryshoi, duke parashikuar se “*nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për vepra penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm*”.

30. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (këto të fundit të konceptuara në funksion dhe të garancive të të drejtave materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive (*shih vendimet nr. 56, datë 9.11.2023; nr. 6 datë 22.2.2022; nr. 5, datë 2.3.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Për sa i takon ndarjes së detyrave midis juridiksionit kushtetues dhe atij të gjyqësorit të zakonshëm, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se ajo ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 34, datë 17.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, detyrë e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Mbi bazën e këtyre standardeve kushtetuese dhe nisur nga konteksti i rrethanave të çështjes, Gjykata do të vlerësojë nëse në rastin në shqyrtim cilësimi juridik i veprës penale nga prokuroria ka ndikuar në rrëzimin e kërkesës së individit për gjykimin sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar dhe nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për

më tepër Gjykata e Lartë, kanë garantuar realizimin e një procesi gjyqësor të drejtë në drejtim të efektivitetit të së drejtës për gjykim të shkurtuar, pra të mosdënimit të tij pa ligj.

33. Gjykata vërtet se prokuroria e ka akuzuar kërkuesin, ndër të tjera, për veprën penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, të kryer në bashkëpunim, duke qenë se gjatë hetimeve ka rezultuar se babai i kërkuesit dhe viktimja janë në lidhje gjinie të afërt (baballarët vëllezër). Gjykata e shkallës së parë ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale në ngarkim të kërkuesit në “Vrasja me dashje”, të parashikuar nga neni 76 i KP-së. Ajo gjykatë ka arsyetuar se kërkuesi me viktimën nuk bëjnë pjesë të “gjinia e afërt”, duke pasur parasysh nenin 16 të KPP-së. Sipas gjykatës së shkallës së parë, duke qenë se kërkuesi dhe viktimja nuk hyjnë në rrethin e personave “gjini e afërt”, faktit penal i duhet dhënë një përcaktim i ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, duke e cilësuar si vrasje me dashje, të parashikuar në nenin 76 të KP-së. Në vijim, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në kushtet kur cilësimi juridik është më i lehtë nga ai i dhënë nga prokuroria, gjykata nuk ka detyrimin ligjor për të njoftuar palët për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, sipas nenit 375 të KPP-së (*shih faqen 36 të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda*). Për rrjedhojë, gjykata e shkallës së parë, mes të tjerave, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprave penale “Vrasja me dashje” (neni 76 i KP-së) dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” (neni 278, paragrafi 1, i KP-së).

34. Ndaj vendimit kanë paraqitur ankim kërkuesi dhe prokuroria. Gjatë shqyrtimit të çështjes, në seancën gjyqësore të datës 4.3.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda ka paraqitur deklaratë për heqjen dorë nga ankimi, ku, mes të tjerave, ka parashtruar se kërkuesi dhe viktimja nuk bëjnë pjesë në rrethin e personave “gjini e afërt” dhe gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka cilësuar si vrasje me dashje, duke i dhënë një përcaktim të ndryshëm nga prokurori. Gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit të prokurorit për shkak të heqjes dorë dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për pjesën e deklarinimit fajtor të kërkuesit sipas veprave penale “Vrasja me dashje” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, si dhe ndryshimin e vendimit vetëm në



lidhje me disponimin për masën e dënimit për veprën penale të vrasjes me dashje.

35. Pretendimi i kërkuesit për mospranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar është shqyrtuar edhe nga gjykata e apelit, e cila e ka gjetur të drejtë e të mbështetur në ligj vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar me të njëjtën linjë si gjykata e shkallës së parë se rastin në gjykim nuk mund të procedohet me gjykimin e çështjes me ritin e gjykimit të shkurtuar, për shkak të parashikimit të nenit 403 të KPP-së, të ndryshuar dhe se e drejta e të pandehurit për të kërkuar zhvillimin e gjykimit me procedurën e gjykimit të shkurtuar shqyrtohet nga gjykata e faktit dhe mbetet atribut i saj (*shih faqet 20 dhe 21, të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda*).

36. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së, duke arsyetuar se nuk konstatohet zbatim i gabuar i ligjit procedural ose material nga gjykata e faktit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e ngritur në rekurs nga kërkuesi për cenimin e së drejtës për të përfutur nga gjykimi i shkurtuar. Ajo gjykatë ka mbajtur qëndrimin se gjykata e apelit ka arsyetuar me të drejtë se për shkak të cilësimit ligjor të akuzës “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, me të cilën akuza ka dërguar për gjykim çështjen e kërkuesit, parashikohej dënimi me burgim të përjetshëm dhe nuk mund të procedohej me procedurën e gjykimit të shkurtuar, referuar nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar. Zhvillimi i gjykimit me procedurën e gjykimit të zakonshëm, nën parimin e kontradiktoritetit, ka bërë të mundur edhe ndryshimin e këtij cilësimi ligjor, në lehtësim të pozitës së kërkuesit (*shih faqen 14, të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

37. Nisur nga sa më lart, Gjykata vëren se qëndrimi i gjykatave të zakonshme për rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar të kërkuesit lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me dy shkaqe: i. me përcaktimin e cilësimit juridik të veprës penale për të cilën kërkuesi është akuzuar nga prokuroria dhe çështja është dërguar për gjykim; ii. me kohën e shqyrtimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar.

38. Për sa i takon *shkakut të parë*, kualifikimit juridik të veprës penale nga ana e prokurorisë, sikurse u përmend më lart (*shih paragrafin 3 të vendimit*), kjo e fundit, duke e cilësuar marrëdhënien

mes autorit të veprës penale/kërkuesit dhe viktimës si lidhje mes kushërinjve, e ka akuzuar atë për veprën penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, të parashikuar nga neni 79/“c” i KP-së, që përcakton dënimin me jo më pak se 20 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dhe për të cilat nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar sipas nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar. Ndërkohë, prokuroria nuk ka analizuar në lidhje me marrëdhënien e posaçme midis autorit dhe viktimës sipas përcaktimeve ligjore, në mënyrë që të justifikonte kualifikimin e veprës penale sipas nenit 79/“c” të KP-së, edhe pse kjo lidhje përbën një rrethanë objektive dhe përcaktuese për cilësimin juridik të veprës penale, e cila nuk mund të ndryshonte gjatë gjykimit. Ajo është mjaftuar me ekzistencën e marrëdhënies së afërt mes kërkuesit dhe viktimës, duke u nisur nga marrëdhënia familjare që kishte gjyshi i autorit me babanë e viktimës, duke mos arsyetuar më tej lidhjen konkrete që kishte kërkuesi me viktimën, qoftë edhe duke iu referuar nenit 16 të KPP-së, ku lidhjet familjare, të gjinisë ose të krushqisë së afërt janë përcaktuar si shkaqe papajtueshmërie me funksionin e gjyqtarit në gjykim.

39. Gjykata gjithashtu vlerëson se kjo rrethanë përforcohet nga fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë e ka rikualifikuar faktin penal dhe kërkuesi është dënuar për veprën penale “Vrasja me dashje”, të parashikuar nga neni 76 i KP-së, për të cilën parashikohet dënimi me jo më pak se njëzet vjet burgim, masë dënimi kjo që nuk përbën kriter kufizues në rastet e paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar, sipas nenit 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar. Në ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, gjykata e shkallës së parë është bazuar në aktet e gjendjes civile, sipas të cilave ka rezultuar se viktimë dhe kërkuesi nuk hyjnë në rrethin e personave “gjini e afërt”, për rrjedhojë kërkuesi, si autor i veprës penale, nuk është subjekt i posaçëm në kuptim të nenit 79/“c” të KP-së.

40. Në vijim, Gjykata vlerëson se në rastin konkret përcaktimi nga prokuroria i marrëdhënies mes autorit të veprës penale dhe viktimës si dy kushërinj, pa treguar konkretisht lidhjen familjare, të gjinisë ose të krushqisë së afërt mes tyre, përbën gabim faktik që ka ndikuar në cilësimin e gabuar të veprës penale. Në këtë pikë vlen të theksohet se marrëdhëniet familjare ose gjinore janë rrethana objektive e përcaktuese për cilësimin juridik të



veprës penale, që nuk pësojnë ndryshim si gjatë hetimit, po ashtu edhe gjatë gjykimit të çështjes dhe nuk lënë hapësira për shqyrtimin/rivlerësimin e tyre, ndaj përcaktimi i saktë i tyre është thelbësor për kualifikimin juridik të veprës penale, pasi ndikon në efektivitetin e së drejtës për gjykim të shkurtuar, pra në të drejtën kushtetuese të mosdënimit pa ligj.

41. *Për sa i takon shkakut të dytë*, kohës së shqyrtimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, Gjykata vëren se kërkesa është paraqitur nga kërkuesi në datën 26.7.2017, para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të nenit 403, pika 2, të KPP-së, por për shkak të shtyrjes së seancave gjyqësore është shqyrtuar në datën 2.11.2017, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore në KPP (*shih paragrafët 4–7 të vendimit*). Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë arsyetuar në lidhje me momentin kohor të paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar ose për mosshqyrtimin e saj në seancën e datës 27.7.2017 për shkaqe që nuk varehin nga vullneti i kërkuesit, pavarësisht se edhe ky shkak ka ndikuar drejtpërdrejt në të drejtën kushtetuese të mosdënimit pa ligj.

42. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se për shkak të gabimit konceptual të organit të prokurorisë në përcaktimin e marrëdhënies mes autorit të veprës penale dhe viktimës, kërkuesit nuk i është dhënë mundësia për të përfituar gjykimin në gjendjen që ishin aktet, sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar, kërkesë që për shkak të momentit procedural kur paraqitet vlerësohet nga gjykata e shkallës së parë bazuar në akuzën e ngritur nga prokurori. Po ashtu, edhe në lidhje me momentin e paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë mbajtur një qëndrim të arsyetuar lidhur me datën e paraqitjes së kërkesës dhe atë të shqyrtimit të saj, të trajtuara këto duke iu referuar kohës kur kanë hyrë në fuqi ndryshimet ligjore në nenin 403, pika 2, të KPP-së. Në këto kushte dhe për më tepër në rrethanat kur organi i prokurorisë ka hequr dorë nga ankimi për shkak të gabimit faktik në përcaktimin prej tij të marrëdhënies midis kërkuesit dhe viktimës, kërkuesit nuk i është dhënë mundësia për të ushtruar të drejtat e tij në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur, pra për të përfituar nga zbatimi i procedurës me gjykim të shkurtuar.

43. Në këtë pikë, Gjykata vlerëson të rritet efektet që sjell gjykimi i shkurtuar për sa i përket masës së dënimit. Zgjedhja e gjykimit të shkurtuar, si rit procesual, ndikon mbi masën ose llojin e

dënimit që caktohet nga gjykata, për rrjedhojë kjo e drejtë procedurale ndikon drejtpërsëdrejti në të drejtën materiale të mosdënimit pa ligj (*shih vendimin nr. 26, datë 29.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Për këto arsye, Gjykata vëren se për shkak të përcaktimit të gabuar të veprës penale nga organi i prokurorisë, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë vendosur refuzimin e kërkesës së kërkuesit për gjykim të shkurtuar, duke i mohuar atij përfitimet e njohura nga ligji për masën e dënimit. Gjykata vlerëson se mënyra sesi kanë vepruar prokuroria e më tej gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat kanë pasur të gjitha hapësirat ligjore për t'i garantuar kërkuesit të drejtën për të përfituar nga gjykimi i shkurtuar gjatë procesit gjyqësor penal, ka sjellë, në thelb, cenimin e garancive efektive kundër dënimit arbitrar në kuptim të së drejtës kushtetuese të mosdënimit pa ligj. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj janë të bazuara. Ndaj, Gjykata çmon se duhet të shfuqizohet vendimi i Gjykatës së Lartë, pasi duke u bazuar në kompetencat e saj si gjykatë ligji është në pozicionin e duhur për të shqyrtuar pretendimin e kërkuesit dhe riparuar gabimet e gjykatave më të ulëta.

45. Në vijim, Gjykata, duke ritheksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë, e cila i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer një rol që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën (*shih vendimet nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 62, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*), vlerëson të mos ndalet në analizimin e pretendimeve të tjera të paraqitura nga kërkuesi për procesin gjyqësor penal të lidhura edhe me pretendimet për nenin 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar, për sa kohë që çështja do të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë.

46. Në përfundim, Gjykata çmon se sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e pjesërisht e bazuar, ndaj dhe ajo pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,



VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1630, datë 3.10.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, vetëm për kërkuesin Renato Sina.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 23.10.2025.

Shpallur më 21.11.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anetarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Fiona Papajorgji, Marjana Semini

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me vendimin nr. 41-2025-1504 (377), datë 6.5.2025, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Dorjana Jaupi e datëlindjes 5.7.1988, si dhe caktimin si kujdestare ligjore nënën e saj, shtetasen Fatime Jaupi.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin nr. 280, datë 19.5.2025, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Romeo Beluli më datë 19.3.2003, i datëlindjes 18.3.1968, me atësi Myfit dhe amësi Elma.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me vendimin nr. 41-2025-2541 (604), datë 15.7.2025, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Valmira Hasimllari (Xhialli), e datëlindjes 13.9.1985, dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë e të vëllait të saj, shtetasit Almir Vladimir Xhihalli.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me vendimin nr. 41-2025-2158 (514), datë 17.6.2025, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Daniel Fatos Shkira, i datëlindjes 2.11.2006, dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë e nënës së tij, shtetases Lindita Skender Shkira.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 288 lekë

